



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE

Nr. 31/58 Prot.

Tiranë më, 14.02.2024

V E N D I M

Nr. 13 datë 14.02.2024

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

Henri Naqellari	Kryesues
Loreta Hanxhari	Relatore
Bora Vrenjo	Anëtare

asistuar nga sekretarja e Sekretariatit Teknik, Znj. Lediana Azemaj në datën 25.01.2024, ora 10:00, në Sallën e Mbledhjeve, kati I, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I VLERËSIMIT:

Z. Arben Gjergji Joco, me funksion aktual Asistent në Departamentin e Policisë Kriminale, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

OBJEKTI:

Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit.

BAZA LIGJORE:

Ligji nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012, “Për Organizimin dhe Funkionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar.

TRUPA E VLERËSIMIT TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE,

pasi dëgjoji dhe vlerësoi shpjegimet dhe argumentimin ligjor të Relatorit të çështjes, Znj. Loreta Hanxhari, dëgjoji subjektin e vlerësimit në seancë dëgjimore, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë, pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi duke u bazuar në Ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Agjencia e Mbrojtjes Policore është institucioni që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbrojtjes Policore, bazuar në Ligjin nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar (në vijim Ligji nr. 12/2018, i ndryshuar).

2. Bazuar në nenin 6, të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, shtetasi *Arben Joco* është subjekt i vlerësimit kalimtar nga Agjencia e Mbrojtjes Policore, për shkak të funksionit që mbante deri datë 06.02.2024, si *Drejtor në Drejtorinë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Tiranë*.

3. Agjencia e Mbrojtjes Policore, më datë 05/04/2022, ka shortuar Trupën Vlerësuese dhe relatorin e çështjes për subjektin e vlerësimit *Z. Arben Joco*, për t’ju nënshtruar procesit të vlerësimit kalimtar, bazuar në dispozitat e Ligjit nr.12/2018, *i ndryshuar*, si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Brendshme nr.07, datë 17.01.2023, “*Për procedurat dhe mënyrat e hedhjes së shortit për trupat e vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit të Ligjit 12/2018, i ndryshuar*”, të përbërë nga Relatore Znj. Loreta Hanxhari, Kryesues Z. Henri Naqellari dhe Anëtare Znj. Bora Vrenjo.

4. Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, më datën 18/04/2023 u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e Trupës së Vlerësimit sipas nenit 27, pika 1, të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar dhe neneve 30 dhe 31, të Kodit të Procedurave Administrative.

5. Trupa e Vlerësimit në përputhje me Ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar si edhe në bazë të Rregullores nr.197, datë 28.02.2023 “*Për hapat proceduralë të unifikuar*”, me Vendimin nr.1, datë 18.04.2023 vendosi:

- *Të fillojë hetimi kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Arben Joco, me funksion Drejtor në Drejtorinë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Tiranë.*
- *Të njoftojë me shkrim subjektin e vlerësimit për fillimin e hetimit.*
- *Të bëhet njohja e subjektit të vlerësimit me përbërjen e Trupës së Vlerësimit për të drejtën e deklaramit të konfliktit të interesit të subjektit me trupën.*

6. Bazuar në nenin 49, të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit *Arben Joco* në datën 18/04/2023 është njoftuar në adresën elektronike zyrtare të tij, për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar, është njohur me përbërjen e Trupës së Vlerësimit, dhe i është kërkuar të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me ndonjë nga anëtarët e trupës së vlerësimit sa më sipër.

7. Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, “Deklaratën për Konfliktin e Interesit” me nr. ** prot. datë 20.04.2023, duke shprehur se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e Trupës së Vlerësimit.

8. Relatori i çështjes në përmbushje të detyrave ligjore të përcaktuara në pikën 3, të nenit 25, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, dhe sipas:

- nenit 7, pika 1, të Rregullores nr. 197, datë 23.02.2023, “*Për hapat proceduralë të unifikuar*”, nenit 4, të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore dhe Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit, ka dërguar me shkresën nr. ** prot., datë 19.04.2023, pranë ILDKPKI-së, formularin e deklarimit të pasurisë për vlerësimin kalimtar të dorëzuar nga subjekti i vlerësimit.
- nenit 7, pika 7, të Rregullores nr. 197, datë 23.02.2023 “*Për hapat proceduralë të unifikuar*”, ka dërguar me shkresën nr. ** prot., datë 19.04.2023, pranë DPPSH-së, formularin e aftësive profesionale për vlerësimin kalimtar të dorëzuar nga subjekti i vlerësimit.
- nenit 7, pika 4, të Rregullores nr. 197, datë 23.02.2023, “*Për hapat proceduralë të unifikuar*”, ka dërguar me shkresën nr. ** prot., datë 19.04.2023, pranë AMP-së, deklaratën e kontrollit të figurës për vlerësimin kalimtar të dorëzuar nga subjekti i vlerësimit.

9. Bazuar në nenin 34, pika 3, nenin 42, pika 1 dhe nenin 46, pika 2, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar janë administruar raportet e hartuara nga institucionet ndihmëse: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Agjencia e Mbikëqyrjes Policore (në vijim AMP) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (në vijim DPPSH). Këto raporte janë administruar nga relatori në fillim të procesit të hetimit administrativ.

10. Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3, të nenit 25, të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimit kalimtar.

11. Për të realizuar procedurat e vlerësimit kalimtar të punonjësve, Trupa e Vlerësimit është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.

12. Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve bazuar në nenin 4, të Ligjit nr.12/2018 (*i ndryshuar*) ka për objekt:

- a) *vlerësimin e pasurisë;*
- b) *kontrollin e figurës;*
- c) *vlerësimin e aftësive profesionale.*

13. Trupa e vlerësimit ka realizuar procesin e hetimit administrativ, bazuar në:

- a) Ligjin nr.12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat” i ndryshuar.
- b) Ligjin nr.128/2021, “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”
- c) Ligjin nr.40/2015, “Kodi i Procedurës Administrative”
- d) Ligjin nr.9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”
- e) Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm, nr.7, datë 17.01.2023, “Për procedurat dhe mënyrat e hedhjes së shortit për trupat e vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit të Ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, i ndryshuar”.
- f) Udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Brendshëm dhe ILDKPKI nr. 15, datë 27.01.2023, “Për miratimin e formularëve të deklarimit të Pasurisë për vlerësimin kalimtar dhe periodik si edhe mënyrën e plotësimit të tyre nga subjektet e vlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarimin e pasurisë në zbatim të Ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme’ i ndryshuar
- g) Rregulloren nr.197, datë 23.02.2023, “Për hapat proceduralë të unifikuar”.

Gjithashtu Trupa e Vlerësimit ka verifikuar dhe vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme dhe konkretisht:

- *Deklarata e Pasurisë,*
- *Deklarata për Kontrollin e Figurës,*
- *Formulari i Vlerësimit Profesional*
- *Dokumentacion bashkëlidhur deklaratave për të justifikuar deklaratimet,*
- *Tri raportet ndihmëse të hartuara nga institucionet shtetërore;*
- *Provat shkresore/dokumente të administruara nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar.*
- *provat dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit.*
- *ka marrë në konsideratë bashkëpunimin, gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të vlerësimit.*

14. Hetimi administrativ përfshiu edhe personat e lidhur apo persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 3, pika 12 dhe 14, të Ligjit nr. 12/2018 të ndryshuar, nenit 3, pika 11 dhe nenit 5, të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

15. Me subjektin e vlerësimit, është komunikuar me anë të postës elektronike duke i bërë pyetje dhe kërkuar sqarime, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave.

16. Trupa e Vlerësimit, pasi dëgjoji relatimin e bërë nga relatorja e çështjes dhe studioi materialin e përgatitur për këtë qëllim, krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, kanë nivelin e provueshmërisë, si dhe pasi konstatuan se janë marrë të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Arben Joco, me Vendimin nr.3, datë 05.01.2024, vendosi :

a) Të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e vlerësimit Arben Joco;

b) Të njoftojë me rrugë elektronike zyrtare subjektin për:

- *Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht dhe*
- *Rezultatet e hetimit të pasqyruara në relacionin paraparak për të tre komponentët, e vlerësimit pasuror, kontrollit të figurës dhe atij profesional;*

c) Të ftojë subjektin për t'u njohur me dosjen dhe me provat e administruara nga Trupa e Vlerësimit, në përputhje me nenin 50, të ligjit nr.12/2018, nenet 35-40 dhe 45-47, të Kodit të Procedurës Administrative, duke i dhënë kohë të arsyeshme prej 5 ditësh për t'u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegime.

17. Subjekti i vlerësimit, pas njoftimit me e-mail datë 08.01.2024, mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Trupa Vlerësuese, nuk e ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve.

II. SEANCA DËGJIMORE

18. Subjekti i vlerësimit Arben Joco u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht me e-mail, në datën 22.01.2024, ku dhe u njoftua se seanca publike dëgjimore është përcaktuar për t'u mbajtur në datën 25.01.2024, ora 10:00, në adresën: Salla e Mbledhjeve Kati I, në ambientet e Ministrisë së Brendshme.

19. Seanca dëgjimore me subjektin u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, në datën dhe adresën e përcaktuar.

20. Subjekti i vlerësimit mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe për të parashtruar shpjegimet dhe opinionet e tij në lidhje me procesin e vlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe të parashtrimeve, subjekti i vlerësimit Arben Joco kërkoi nga Trupa Vlerësuese konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT

21. Z. Arben Joco ka qenë bashkëpunues në procesin e vlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar dhe gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ ka zbatuar me përpikmëri afatet e përcaktuara nga Trupa Vlerësuese, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur i janë kërkuar. Subjekti ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. ARSYETIMI LIGJOR I TRUPËS SË VLERËSIMIT

A. VLERËSIMI I PASURISË

22. Në bazë të nenit 32, pika 1, të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, punonjësi deklaron çdo pasuri, të luajtshme apo të paluajtshme, të fituar, poseduar, përdorur apo tjetërsuar që nga data e fillimit të marrëdhënies së punës në institucionin përkatës, pavarësisht datës së emërimit në pozicionin dhe/ose gradën që mban, deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë.

23. Trupa e Vlerësimit ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe fakt, për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për punonjësin dhe për personat e lidhur me të, të parashikuar në nenin 31, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.

24. Deklarimi i pasurisë nga subjekti kryhet sipas parashikimeve të nenit 32 e 33, ndërsa procedura e vlerësimit të pasurisë nga Trupa e Vlerësimit kryhet sipas përcaktimeve të nenit 34, të Ligjit nr. 12/2018 të ndryshuar.

25. Sipas kreut III, neni 33/1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ILDKPKI-ja bazuar në deklarimet e pasurisë, zhvillon një procedurë të plotë kontrolli dhe në përfundim përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

26. Hetimi administrativ i Trupës Vlerësuese pasi administroi dhe u njoh me Raportin e ILDKPKI-së, konsistoi në:

- *verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të deklaruar nga subjekti i vlerësimit;*
- *në verifikimin e burimit/eve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruara si edhe në mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet financiare të deklaruara;*
- *në evidentimin e ndonjë fshetjeje të mundshme të sendeve në pronësi apo në përdorim;*
- *në evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme si edhe evidentimit të rasteve të konfliktit të interesit.*

27. Trupa e Vlerësimit për të arritur në një konkluzion sa më të drejtë, ka thelluar hetimin nëpërmjet:

- a) shqyrtimit të të dhënave të deklaratës së pasurisë së vlerësimit kalimtar;
- b) krahasimit të deklaratave të pasurive të dorëzuara në ILDKPKI për periudhat përkatëse, në raport me të dhënat në deklaratën e vlerësimit kalimtar;
- c) shqyrtimit të të dhënave nga të gjitha bankat e nivelit të dytë, institucionet financiare dhe jo financiare, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, organet tatimore, organet e tjera shtetërore, personat juridikë, individët, si dhe likuiditeteve – gjendje cash;
- ç) hetimit të kryer lidhur me të dhënat e vetë deklaruara nga subjekti gjatë plotësimit të pyetësorëve të dërguar.

28. Trupa e Vlerësimit i ka vlerësuar këto deklaratime së bashku me provat e tjera në tërësi dhe harmoni me të gjitha rrethanat e çështjes.

29. Subjekti i vlerësimit Z. Arben Joco ka plotësuar dhe dorëzuar deklaratën e pasurisë dhe dokumentacion justifikues për të justifikuar vërtetësinë e deklaratimeve, ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, në zbatim të nenit 32, pika 2, të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.

30. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33/1, pika 3 e Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka konstatuar se:

- a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare;
- b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d) nuk ka kryer deklaram të rremë;
- e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

DEKLARIMI I PASURIVE NGA SUBJEKTI I VLERËSIMIT

- 1. Shtëpi banimi private, dy kate dhe një kat garazh, me sipërfaqe 115.43 m², ndodhur në lagjen nr. 4, rruga "Stavri Shkurti", në qytetin e Korçës, Njësia Administrative nr. 2, e cila është në pronësi të babait, i cili nuk jeton.**

Burimi: Është ndërtuar me kontribute e shpenzime të përbashkëta (babait, vëllait tim L. Joco dhe unë) në periudhën kohore 1992 e në vazhdim. Nr. xx, zk. 8562, vol. xx, faqe xx. datë 06.12.2004. Vlera 3.000.000 lekë. Zotëron 50%.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

1.1 ASHK Drejtoria e Përgjithshme, me shkresë me nr. ** prot., datë 12.06.2023, konfirmon se shtetasi Arben Gjergji Joco dhe familjarët e tij, nuk figurojnë aplikues për vetë deklaramin e ndonjë objekti informal në funksion të përfshirjes në procesin e legalizimeve.

1.2 ASHK, Drejtoria Vendore Korçë, me shkresë nr. ** prot., datë 22.06.2023, nuk konfirmon pasuri të regjistruara në emër të Arben Gjergji Joco dhe familjarëve të tij.

1.3 ASHK online, konfirmon se Gjergji Joco ka të regjistruar pasurinë në zk. 8562, nr. pasurie xx, vol. xx, faqe xx, nr. i hartës: KO; R-11.

Subjekti ka sqaruar se:

1.4 Shtëpia e banimit private, 2 (dy) kate plus një kat garazh, me sip. ndërtimi 115.43 m², në lagjen nr. 4, Rr. "Stavri Shkurti", Korçë është ndërtuar me kontribut të përbashkët nga prindërit, vëllai L. Joco dhe kontributi familjar i subjektit, për periudhën nga viti 1992 deri në momentin kur është bërë funksional për banim në vitin 2004.

- 1.5 Vlera e investimit material për gjithë periudhën e ndërtimit të shtëpisë për vitet 1992 - 2004 ishte rreth 3.052.000 lekë. Në këtë shtëpi posedon 50 % subjekti me familjen dhe 50 % vëllai L. Joco, i cili banon në SHBA. Shtëpia është akoma e regjistruar në pronësi të babait të subjektit, Gjergji Joco, i cili ka ndërruar jetë në datë 30.05.2005.
- 1.6 Kjo shtëpi ishte ndërtuar në truallin me sip.210 m², në territorin e Bashkisë Korçë dhe është blerë nga babai i subjektit, Gjergji Joco, me kontratë shit-blerje me nr. ** rep., dhe nr. ** kol., datë 08.06.1995, me palë shitëse Seksioni i Financës së Rrethit Korçë, në vlerën 24.563 lekë. Kjo vlerë është paguar nga babai i subjektit Gjergji Joco. Për këtë pronë nuk kanë filluar procedurat për regjistrimin dhe ndarjen në emër të subjektit dhe vëllait të tij L. Joco, pasi vëllai i subjektit aktualisht jeton në SHBA. Në shtëpinë e banimit kanë punuar bashkërisht babai i subjektit Gjergji Joco, vëllai L. Joco dhe subjekti, dhe shpenzimet e punimeve janë mbuluar nga puna e tyre. Në këtë investim pjesa takuese e subjekti është 1/3, rreth 1.100.000 lekë, ndërsa pjesa tjetër prej rreth 2.000.000 lekë janë investim i prindërve nga kursimet e tyre, por kryesisht të ardhurat nga puna e vëllait L. Joco, i cili për periudhën e viteve 1992- 2004, ka punuar në Greqi bashkë me bashkëshorten e tij, si emigrant, me profesion agronom.
- 1.7 Burimi i krijimit për pjesën takuese të investimit për ndërtimin e shtëpisë janë kursime nga të ardhurat e pagës së subjektit në Policinë e Shtetit nga viti 1984 deri në vitin 2004, në shumën rreth 4.119.181 lekë dhe të ardhurat nga biznesi i bashkëshortes Marika Joco, me aktivitet "Farmaci" nga viti 1995 deri në 31.12.2002, të deklaruara në shumën 3.000.000 lekë, referuar xhiros mujore dhe vlerës së rimbursimeve.
- 1.8 Për të ardhurat e deklaruara nga bashkëshortja nga viti 1995 deri në vitin 2002 nga aktiviteti privat në shumën rreth 3.000.000 lekë, referuar xhiros mujore dhe vlerës së rimbursimeve, subjekti ka sqaruar se për të vërtetuar të ardhurat e bashkëshortes Marika Joco nga aktiviteti privat "Farmaci" në qytetin e Korçës për periudhën 01.02.1995 deri më 31.12.2002, të cilat referuar xhiros mujore dhe vlerës së rimbursimit janë deklaruar afërsisht në shumën rreth 3.000.000 lekë, nuk ka gjetur dokumentacion nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve, Zyra e Shërbimeve për Tatimpaguesit Korçë.
- 1.9 Për periudhën e viteve 1995 - 2002, sipas DRT Korçë me shkresën e ardhur nr. ** prot. datë 06.07.2023, rezulton se nga verifikimi i regjistrave manualë të ndodhura pranë DSHT është gjetur informacioni si vijon: *Për vitin 1998* - Marika Dhimitër Joco me kod fiskal 160654, me objekt aktiviteti Farmaci me adresë L. 4, Rr."N. Kapo", nr. 4, me *paradhënie tatimi 50.000 lekë*. *Për vitin 2002* - Marika Dhimitër Joco me kod fiskal 160654, me objekt aktiviteti Farmaci me adresë L. 14, Rr."V. Eftimiu", me *paradhënie 60.000 lekë*. Nga verifikimet i të gjithë regjistrave manualë që ndodhen në Zyrën e Shërbimit për Tatimpaguesit në DSHT Korçë, nuk është gjetur informacion për subjektin Marika Joco me NIPT K33929020V për vitet 2003 - 2004.
- 1.10 Trupa Vlerësuese ka konstatuar se nga statement bankar i llogarisë në lekë të Marika Joco (Pine) pranë BKT Bank, janë transferuar pagesa likuidime për Tatim Thjeshtuar Fitimi si më poshtë rezulton:

Datë	Tatim Fitimi (në ALL)
03.09.2003	40000 lekë
31.03.2004	30000 lekë për vitin 2003, 15000 lekë për vitin 2004
24.09.2004	30000 lekë (për 6 muj. II 2004)
17.12.2004	40000 lekë
11.03.2005	15000 lekë (kësti 3/04)

1.11 Nisur nga të dhënat e mësipërme për vitet (1998, 2002, 2003, 2004) për të cilat është mundur të sigurohet informacion rreth tatimit të fitimit të thjeshtuar të dhënë si paradhënie për vitet 1998 dhe 2002 dhe për tatimin e derdhur për vitet 2003 dhe 2004, rezulton që të ardhurat nga aktiviteti të jenë në shumën rreth 2.800.000 lekë dhe fitimi pas tatimit në shumën 2.520.000 lekë.

1.12 Për vitin 2003 të ardhurat kanë rezultuar të jenë 700.000 lekë sipas përlogaritjes së tatimit të paguar, gjë e cila përputhet dhe me deklaratën e dorëzuar pranë ILDKPKI-së, sipas formularit A-6, të saj.

1.13 Në lidhje me shpenzimet për mobilimin e shtëpisë, subjekti sqaron se ato janë kryer ndër vite dhe nuk kanë ruajtur fatura blerjesh për arredimin dhe blerjen e pajisjeve elektroshtëpiake. Për shkak se kanë kaluar shumë vite nuk përcaktoi vlerat e shpenzuara për mobilimin e shtëpisë në Korçë, por sqaroi se shpenzimet janë në vlera modeste.

1.14 Subjekti ka paraqitur:

- Kontratë Shit-Blerje me nr. ** rep., dhe nr. ** kol., datë 08.06.1995, për truallin me sip. 210 m², me palë shitëse Seksioni i Financës së Rrethit Korçë dhe palë blerëse Gjergji Joco, në vlerën 24.563 lekë; Certifikatë për Vërtetim Pronësie datë 17.12.2004 për truallin me sip. 210 m² nga kjo ndërtesë me sip. 115.43 m², zk. 8562, nr. pasurie xx, vol. xx, faqe xx, adresa Lagje e Re - Korçë, në pronësi të Gjergji Joco;
- Preventiv për objektin 2 (kate) me bodrum, me investitor Gjergji Joco, që konfirmon vlerën e investimit në shumën rreth 3.052.177 lekë, nga "Studio Private Projektimesh Studimesh Monitorimesh Arbi". Bashkëlidhur: Licenca e "Studios Private për Projektme Studime Monitorime Arbi" me Nr. Licence 6894/6, 4 (katër) foto të shtëpisë.

1.15 Për të saktësuar faktin që pjesa takuese në investimin e shtëpisë së banimit të subjektit të vlerësimit, të deklaruar nga ana e tij, është 1/3, rreth 1.100.000 lekë, ndërsa pjesa tjetër prej rreth 2.000.000 lekë janë investim i prindërve nga kursimet e tyre, por kryesisht të ardhurat nga puna e vëllait L. Joco, i cili për periudhën e viteve 1992-2004, ka punuar në Greqi bashkë me bashkëshorten e tij, si emigrant, me profesion agronom, i është kërkuar subjektit që ky fakt të konfirmohet edhe nga vëllai i tij, Z. L. Joco, i cili me deklaratën e datës 28.11.2023 deklaroi me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë se : “ Ndërtimi i shtëpisë tonë të përbashkët është kontribut i të gjithëve, investim i prindërve tanë, vëllait tim Arben Joco dhe i imi. Në një investim total

prej rreth 3 milion lekësh, vëllai im Arben ka një, kontribut prej rreth 1.1 milion lekë dhe pjesa tjetër e investimeve janë i imi dhe i prindërve tanë.”

- 1.16 Gjithashtu nga krahasimi i vlerës së investimit të deklaruar sipas preventivit të detajuar me zërat përkatës të punimeve, të dorëzuar nga subjekti, dhe llogaritjes së vlerës sipas kostos mesatare të ndërtimit për qytetin e Korçës bazuar në Entin Kombëtar të Banesave, nga vitet 1992 deri në vitin 2004 që është ndërtuar shtëpia, rezulton një vlerë e përafërt me atë që deklarohet nga subjekti.
- 1.17 Në lidhje me këtë pasuri u konstatua se në Certifikatën e Pasurisë së pronës me numër pasurie xx, volumni xx, faqe xx, Zona Kadastrale nr.8562 rezulton që adresa është: Korçë, Lagje Re.
- 1.18 Gjithashtu në faturat e konsumit të energjisë elektrike të vërtetuara nga FSHU, adresa e subjektit (pasurisë në fjalë) si abonent rezulton të jetë: Lagje Re, Korçë.
- 1.19 Në deklarinimin e pasurisë, subjekti për të njëjtën pasuri ka deklaruar adresën: Lagjja nr.4, Rruga “Stavri Shkurti”, Korçë.
- 1.20 Sa më sipër, i është kërkuar subjektit të japë shpjegimet e tij dhe nëse bëhet fjalë për të njëjtën pasuri.
- 1.21 Subjekti ka sqaruar në kthim përgjigje: *“se në momentin kur u lidhën kontratat për ujë dhe drita, adresa e parë quhej “Lagjja e Re”, për shkak se ishte lagjja në ndërtim e sipër. Aktualisht ku ndërtimet në lagje dhe rrugët janë përfunduar, bashkia ka bërë urbanizimin e saj duke vendosur bllokun e ri të banimit ose “Lagjen e Re” në përbërje të Lagjes nr.4, si dhe rrugën në të cilën ndodhet banesa ime e emërton “Stavri Shkurti”.”*
- 1.22 Nga Trupa Vlerësuese është kryer analiza financiare si në tabelën nr.1 më poshtë për investimin e pjesës së subjektit në shtëpinë e tij të banimit, në vlerën 1.017.392 lekë për periudhën 1992-2004 kur është përfunduar shtëpia, nga e cila, subjekti rezulton me balancë pozitive.
- 1.23 Subjekti për këtë pasuri plotëson kushtin e përcaktuar në nenin 32, pika 1.1. të ligjit 12/2018, i ndryshuar, por për transparencë dhe meqenëse kjo është e vetmja pasuri e paluajtshme që subjekti ka vënë dhe ka që nga fillimi i detyrës deri në datën e dorëzimit të deklaratës, u pa e arsyeshme të analizohej justifikimi i ligjshmërisë së burimit.
- 1.24 Bazuar në deklarinimin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar, në mënyrë të përmbledhur rezulton se: Shtëpia e banimit dy kate + një kat garazh, me sipërfaqe ndërtimi 115.43 m², me adresë Rr. "Stavri Shkurti" Korçë, në zotërim 50% të subjektit deklarues dhe 50 % të vëllait të tij L. Joco është krijuar për periudhën e viteve 1992 - 2004 dhe është regjistruar në pronësi të babait të subjektit Gjergji Joco, i cili ka ndërruar jetë.

1.25 Investimi i subjektit në ndërtimin e shtëpisë është 1/3 e vlerës totale, në shumën rreth 1.100.000 lekë me burim nga të ardhurat nga puna e tij në Policinë e Shtetit, nga viti 1984 - 2004 dhe të ardhurat nga aktiviteti privat "Farmaci" në emrin e bashkëshortes.

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ASHK online. Subjekti Arben Joco dhe vëllai i tij, posedojnë nga 50% pjesë takuese në banesën dhe garazhdin në lagjen nr. 4, rruga "Stavri Shkurti" Korçë, e regjistruar në pronësi të babait Gjergji Joco, e ndërtuar gjatë periudhës 1992 - 2004, me kontribut familjar.**
- ✓ **Konstatohet se subjekti ka pasur mundësi financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë.**

**2. Makinë tip "Volkswagen Golf V Plus", viti i prodhimit 2007, blerë në vitin 2022, nr. kontratës xxx, Certifikata me nr. xxx. Targa xxx. Nr.Shasisë xxxx.
Burimi:Nga kursimet dhe të ardhurat familjare. Vlera 400.000 lekë. Zotëron 100 %.**

2.1 Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë shitje pasurie e luajtshme (automjet) me nr. ** rep., dhe nr. ** kol., datë 24.10.2022, për automjetin e markës Volkswagen, tipi Golf Plus, me nr. shasie xxxx, me targa xxx, blerë në vlerën 3.000 euro, me palë shitëse shtetasen S. Z., e përfaqësuar nga shtetasi H. M. dhe palë blerëse shtetasin Arben Joco. Bashkëlidhur: Kartë identiteti e shtetasit Arben Joco me nr. personal xxx; Kartë identiteti e shtetasit H. M. me nr. personal xxx; Kartë identiteti e shtetases S. Z.me nr. personal xxx.
- Prokurë e posaçme me nr. ** rep., dhe nr. ** kol., datë 24.03.2022, që konfirmon se shtetasja S. Z. e datëlindjes 29.03.1989 ka emëruar si përfaqësues H. M. i datëlindjes 04.11.1993, që ta përfaqësojë në zyrat noteriale të Shqipërisë që të nënshkruajë aktin e shitblerjes për mjetin në emrin e saj: autoveturë Volkswagen tipi Golf Plus, me nr. shasie xxxx, prodhim i vitit 2007, ngjyrë blu e errët, me targa xxx. Bashkëlidhur: Leje qarkullimi në emrin e S. Z., për automjetin e markës Volkswagen, tipi Golf Plus me targa xxx; Certifikatë pronësie datë 10.06.2021, për automjetin e markës Volkswagen, tipi Golf Plus, me xxx në pronësi të S. Z.; Vërtetim me vulë elektronike nga DPSHTRR, datë 24.10.2022 që vërteton se pronari i mjetit S. Z., për mjetin me targa xxx, për periudhën deri me datë 24.10.2022, nuk është debitor për taksën vjetore të mjeteve të përdorura, gjobat e kontrollit teknik, gjoba të kontrollit në rrugë apo nuk është bllokuar nga organet kompetente të përcaktuara me ligji; Regjistrimi i Barrëve Siguruese.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

2.2 DPSHTRR, me shkresë me nr. ** prot., datë 12.05.2023, konfirmon se Arben Gjergji Joco me nr. identifikimi xxx, ka të regjistruar automjetin me targa xxx, i markës Volkswagen Golf Plus me numër shasie xxxx, blerë me kontratë shitje pasurie e luajtshme (automjet) me nr. ** rep., dhe nr. ** kol., datë 24.10.2022 në vlerën 3.000 euro, me palë shitëse shtetasen S. Z. e përfaqësuar nga shtetasi H. M. Bashkëlidhur, dosja e automjetit me targa xxx.

2.3 Subjekti ka sqaruar se automjetin tip "Volkswagen" Golf V Plus", me targa xxx, e ka blerë në vlerën 3.000 euro, sipas kontratës së shitblerjes dhe vlera e deklaruar në shumën 400.000 lekë është lapsus në deklaram.

- ✓ **Bazuar në deklarin e subjektit dhe në analizën financiare të kryer për këtë pasuri, në mënyrë të përmbledhur rezulton se Automjeti tip Volkswagen Golf Plus, me targa xxx, në pronësi të subjektit është blerë në vitin 2022, me burim nga kursimet dhe të ardhurat familjare.**
- ✓ **Konfirmohet automjeti i deklaruar me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e DPSHTRR.**
- ✓ **Konstatohet se subjekti ka pasur mundësi financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë.**

3. Depozitë bankare pranë Intesa Sanpaolo Bank, në emër të z. Arben Joco, me interes 2 vjeçar.

Burimi: Nga kursimet dhe të ardhurat familjare. Vlera 2.120.025,25 lekë. Zotëron 100 %.

3.1 Bashkëlidhur deklaratës:

- Dokument bankar nga Intesa Sanpaolo Bank, datë 27.02.2023, që konfirmon se Arben Joco në datë 01.07.2021 ka hapur depozitë me afat 2 vjeçar, në shumën 2.120.025 lekë.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

3.2 Intesa Sanpaolo Bank, me shkresë me nr. ** prot., datë 19.05.2023, konfirmon se Arben Joco në vitin 2012 ka krijuar depozitën në shumën 500.000 lekë. Për periudhën e viteve 2012 - 2017, depozita rezulton e shtuar në shumën 1.507.600 lekë dhe kishte gjendje 2.007.600 lekë. Pas vitit 2017 rezulton se nuk ka pasur kreditime dhe depozita është shtuar çdo 2(dy) vjet nga interesat bankare. Gjendja e depozitës në datë 07.03.2023 është 2.120.025 lekë.

- ✓ **Konstatohet: Depozita në Intesa Sanpaolo Bank është krijuar duke filluar nga viti 2012 deri në vitin 2017, me burim kursime nga të ardhurat familjare.**
- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e Intesa Sanpaolo Bank.**

- ✓ **Nga analiza financiare e kryer, konstatohet se subjekti ka pasur mundësi financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë.**

4. Llogari rrjedhëse e lidhur me pagën në Banka e Tiranës, në emrin Arben Joco. Deri në 31 janar 2023. Vlera 140.814,38 lekë. Zotëron 100 %.

4.1 Bashkëlidhur deklaratës:

- Nxjerrje llogarie nga Tirana Bank, datë 27.02.2023, që konfirmon se Arben Joco ka llogari rrjedhëse me gjendje në datë 30.01.2023, në shumën 148.312 lekë.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

4.2 Tirana Bank, me shkresë me nr. ** prot., datë 12.05.2023, konfirmon se Arben Joco ka llogari page me gjendje 07.03.2023, në shumën 182.644 lekë.

- ✓ **Konstatohet: Llogaria është krijuar gjatë periudhës 2011 - 2023.**
- ✓ **Konfirmohet deklarami me dokumentacionin e dorëzuar. Tirana Bank konfirmon gjendje llogarie në datë 07.03.2023, në shumën 182.644 lekë, me burim të ardhurat nga pagat.**
- ✓ **Nga analiza financiare e kryer, konstatohet se subjekti ka pasur mundësi financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë.**

5. Prindërit e mi zotërojnë një sipërfaqe toke, prej rreth 9000 m2, ndodhur në fshatin Boboshticë, Njësia Administrative Drenovë, Korçë, përfituar nga Ligji 7501. Është në proces regjistrimi. Nga kjo sipërfaqe më takon (familjes) rreth 30%.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

5.1 ASHK, Drejtoria Vendore Korçë, me shkresë nr. **, datë 22.06.2023, nuk konfirmon pasuri të regjistruara në emër të Arben Gjergji Joco dhe familjarëve të tij.

5.2 Subjekti sqaroi se në fshatin Boboshticë, Korçë, familja e babait Gjergji Joco ka përfituar nga Ligji 7501 "Për tokën bujqësore", tokë me sip. rreth 9000 m2. Pas vdekjes së babait, subjekti mendon se pjesa takuese në këtë sipërfaqe toke është rreth 1/3.

5.3 Kanë bërë kërkesë dhe janë në proces të marrjes së përgjigjes nga Njësia Administrative Drenovë. Nuk disponon AMTP apo certifikatën e pronësisë së tokës.

5.4 Një pjesë e kësaj sipërfaqe toke, afërsisht 20%, është mbjellë nga babai i subjektit Gjergji Joco, me pemë frutore dhe prodhimet e tyre janë përdorur për konsum familjar.

5.5 Në tokën me sip. 9000 m², të ndodhur në fshatin Boboshticë, Njësia Administrative Drenovë, Korçë të përfituar nga Ligji 7501, pjesa takuese e subjektit është rreth 1/3, pasi pjesëtar në pasuritë e lëna nga babai i subjektit, janë subjekti me familjen, vëllai i tij; me familjen dhe nëna e subjektit, e cila jeton në shtëpinë e deklaruar në qytetin e Korçës.

5.6 Për këtë pasuri nuk kanë filluar procedurat e regjistrimit dhe deklarimi nga subjekti i pjesës takuese është me përafërsi.

5.7 Subjekti paraqiti:

- Certifikatë Familjare datë 29.06.2023, që i referohet gjendjes familjare të vitit 1994 dhe konfirmon se në periudhën e përfitimit të tokës bujqësore, ishte në trung familjar me prindërit.
- Vërtetim datë 11.07.2023, nga Njësia Administrative Drenovë, që konfirmon se Gjergji Joco ishte banor në fshatin Boboshticë dhe është trajtuar me tokë bujqësore në fshatin Boboshticë në bazë të Ligjit 7501.

✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar.**

✓ **Nuk është dokumentuar sa sipërfaqe toke ka përfituar babai me AMTP, si përfaqësues i familjes bujqësore.**

6. Shitje e automjetit tip Benz me targë xxx. Sipas kontratës së shitblerjes nr. repertori xx, datë 27.07.2020. Vlera 150.000 lekë.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

6.1 Në ILDKPKI është administruar Kontratë Shitblerje Pasurie e Luajtshme (automjeti) me nr. ** rep., dhe nr. ** kol., datë 27.07.2020, për automjetin e markës Mercedes Benz, me nr. shasie xxxx, me palë shitëse: Arben Gjergji Joco dhe palë blerëse V. Sh., në vlerën 150.000 lekë.

6.2 DPSHTRR, me shkresë me nr. ** prot., datë 12.05.2023, nuk konfirmon automjetin me targa xxx. DPSHTRR, me postë elektronike datë 10.07.2023, konfirmon se subjekti Arben Joco (Joca), nuk ka pasur të regjistruar automjetin me targa xxx.

6.3 Subjekti sqaroi se automjetin tip Benz Mercedes e ka blerë në vitin 2007 në vlerën 250.000 lekë, me burim të ardhurat nga pagat dhe të ardhurat nga aktiviteti privat i bashkëshortes. Ky automjet ka pasur targa EL xxx B dhe më pas targat KO xxx A. Deklarimi i vlerës prej 500.000 lekë i automjetit tip Benz Mercedes, me targë KO xxx A, në deklaratën e interesave privatë "PFD 2017" ishte lapsus në deklaram.

6.4 Paraqiti:

- Kontratë Shitblerje (automjeti) me nr. ** rep., dhe nr. **, datë 28.12.2007, për automjetin e markës Mercedes Benz, me nr. shasie xxxx, me palë shitëse: P.K. dhe palë blerëse Arben Gjergji Joco, në vlerën 250.000 lekë.
- ✓ **Konstatohet: Automjeti është blerë në vitin 2007 me vlerë 250.000 lekë dhe është shitur në vitin 2020 në vlerën 150.000 lekë.**
- ✓ **Subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me blerjen/shitjen e automjetit tip Benz Mercedes me targa KO xxx A.**
- ✓ **Nga analiza financiare e kryer, konstatohet se subjekti ka pasur mundësi financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë.**

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

1. Të ardhura nga paga si punonjës policie, për periudhën 1984 - 1994, me funksion: Specialist e Shef në Seksionin për Krimin Ekonomik Shkodër, Shef Policie Rrethi, Shef Komisariati etj. Shuma 140.460 lekë.
2. Të ardhura nga pagesa e reformës për periudhën janar 1994 - janar 1997. Shuma 146.200 lekë.
3. Të ardhura nga pagat në funksionet: Shef Komisariati Kolonjë, Devoll, Gramsh, Drejtor Policie Qarku Korçë, Zv/Drejtor Policie Elbasan, Shef i Sektorit të Luftës Kundër Narkotikëve DPSH. Drejtor i Policisë Qarkut Elbasan, për periudhën gusht 1997 deri në 31.03.2005. Vërtetuar nga librat e llogarive në borderotë e institucioneve përkatëse. Shuma 3.377.742 lekë.
4. Të ardhura nga paga si Drejtor i Drejtorisë së Qarkut Elbasan, Shef i Sektorit të Luftës Kundër Trafikeve në DPPSH, si dhe nga paga për reformë, për periudhën 01.04.2005 deri 01.07.2009. Vërtetim nga ekstrakti bankar, marrë pranë Raiffeisen Bank. Shuma 3.807.407 lekë.
5. Të ardhura nga pensioni i parakohshëm (Statusi i ushtarakut) për periudhën 01.07.2009 deri në 31.03.2011. Vërtetuar nga vërtetimi i marrë pranë ISSH - Korçë. Shuma 384.363 lekë.
6. Të ardhura nga paga, shpërblimet trajtimi me uniformë civile, dieta etj., si specialist në DPPSH, Shef i Sektorit të Luftës Kundër Trafikeve në DPPSH, Drejtor i DVKM Korçë, Gjirokastër, Shkodër e Tiranë, për periudhën 01.04.2011 - 28.02.2023. Shuma 12.282.059 lekë.

7. Shuma gjithsej: 20.138.231 ALL (Njëzet milion e njëqind e tridhjetë e tetë mijë e dyqind e tridhjetë e një) lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Nxjerrje llogarie nga Tirana Bank, datë 27.02.2023, që konfirmon se Arben Joco ka llogari page dhe për periudhën 05.01.2018 - 09.01.2023 i janë kredituar të ardhura neto nga pagat, shpërblimet, dieta, trajnime, etj., nga Drejtoria Vendore e Kufirit dhe Migracionit Korçë dhe Drejtoria Vendore e Kufirit dhe Migracionit Shkodër, në shumën rreth 6.002.000 lekë.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

8. Raiffeisen Bank, me shkresë me nr. ** prot. datë 08.05.2023, përcjellë CD që konfirmon se Arben Joco ka pasur llogari page dhe për periudhën 18.09.2006 - 01.07.2009 i janë kredituar në llogari të ardhura neto nga pagat, dieta, reforma, në shumën rreth 2.229.140 lekë.
9. Intesa Sanpaolo Bank, me shkresë me nr. ** prot., datë 19.05.2023, konfirmon se Arben Joco ka pasur llogari rrjedhëse në usd dhe për periudhën 29.10.2015 - 01.12.2015, i janë kredituar në llogari të ardhura nga pjesëmarrja në trajnime nga UNDP, në shumën rreth 1.030 usd. Arben Joco, ka pasur llogari rrjedhëse në euro dhe për periudhën 21.6.2016 - 4.9.2017 i janë kredituar në llogari të ardhura nga misioni në Milano, misioni në Prishtinë dhe trajnim në Prishtinë, në shumën rreth 1.010 euro.
10. Tirana Bank, me shkresë me nr. ** prot., datë 12.05.2023, konfirmon se Arben Joco ka pasur llogari page dhe për periudhën 09.05.2011 - 03.03.2023 i janë kredituar në llogari të ardhura neto nga pagat, shpërblimet, dieta, trajnime, etj., nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria Vendore e Kufirit dhe Migracionit Korçë, Drejtoria Vendore e Kufirit dhe Migracionit Shkodër, në shumën rreth 12.386.553 lekë.
11. ISSH, me shkresë me nr. ** prot., datë 10.05.2023, konfirmon se Arben Joco për periudhën dhjetor 2012 - mars 2023 ka përfituar të ardhura neto nga paga pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, Departamenti për Krimin Organizuar dhe Krimet e Rënda, Drejtoria e Forcës së Posaçme Operacionale, Drejtoria e Përgjithshme për Hetimin e Krimin të Organizuar, Drejtoria Vendore e Kufirit dhe Migracionit Korçë, Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit dhe Policia e Kufirit dhe Migracionit. ISSH, me shkresën nr. ** prot., datë 09.05.2023, i ka dërguar shkresë Drejtorisë së Arkivit Qendror Lundër, për të konfirmuar të ardhurat e realizuara nga shtetasi Arben Gjergji Joco dhe familjarët e tij, për periudhën para vitit 2012.

12. ISSH, Drejtoria e Arkivit Qendror, me shkresën kthim përgjigje me nr. ** prot., datë 17.05.2023, nuk konfirmon të dhëna për periudhën 1994 - 2012, për shtetasin Arben Gjergji Joco dhe familjarët e tij.
13. Subjekti ka sqaruar se për të ardhurat nga pagat e përfituara nga puna në Policinë e Shtetit nga viti 1984, të deklaruara në deklaratën e pasurisë për vlerësim kalimtar, ka mundur të sigurojë vërtetime të ardhurash të nxjerra nga sistemi. Për periudhën korrik 2009 - mars 2011, subjekti është liruar nga puna në policinë e shtetit dhe është trajtuar me pension të parakohshëm ushtaraku. Të ardhurat e përfituara nga subjekti për periudhën 01.07.2009 - 31.03.2011 nga pensioni i parakohshëm i ushtarakut ishin në shumën 384.363 lekë. Këto të ardhura i ka tërhequr në sportelet e postës.
14. Sqaroi se për periudhën maj 2011 - prill 2018, të ardhurat nga pagat konfirmohen edhe nga sistemi bankar në Tirana Bank.
Paraqiti:
- Vërtetim mbi bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare e muajit prill 2018 nga Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit Korçë, që konfirmon se Arben Joco për periudhën korrik 1984 - dhjetor 1988, ka përfituar të ardhura në shumën 36.540 lekë.
 - Vërtetim mbi bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare nga Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit Korçë, që konfirmon se Arben Joco, për periudhën janar 1989 - mars 1991, ka përfituar të ardhura nga pagat në shumën 20.520 lekë.
 - Vërtetimin me nr. ** prot., datë 23.12.2019, nga Drejtoria Vendore e Policisë Korçë, që konfirmon se Arben Joco, për periudhën 16.03.1991 - 20.01.1994, ka qenë punonjës me detyrë Zv/ Kryetar, Shef në Komisariatin e Policisë Ersekë dhe Shef i Rendit në Komisariatin e Policisë Kolonjë që ka përfituar të ardhura neto nga pagat në shumën rreth 140.779 lekë. Për periudhën 20.01.1994 - 20.01.1996 është trajtuar me pagë kalimtare (Reformë) si ish -punonjës policie në Komisariatin e Policisë Kolonjë (DRP Ersekë) dhe ka përfituar 92.604 lekë; për periudhën 18.08.1997 - 08.02.1998 ka qenë në funksionin e Shefit të Komisariatit Kolonjë dhe ka përfituar 82.750 lekë bruto dhe 75.000 lekë neto. Për periudhën 09.02.1998 - 30.11.1998 ka qenë në funksionin e Shefit të Komisariatit Devoll dhe ka përfituar 214.600 lekë bruto dhe 199.600 lekë neto. Për periudhën 01.12.1998 - 22.06.1999 ka qenë në funksionin Drejtor Policie në Prefekturën Korçë dhe ka përfituar 205.370 lekë bruto dhe 181.924 lekë neto.
 - Vërtetim me nr. ** prot., datë 24.12.2019 nga D.V.P. Elbasan, me anë të së cilit vërtetohet se Arben Joco, ish efektiv i Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan është trajtuar me pagesat si vijon: Për periudhën 22.09.1999 - 16.06.2002: të ardhura nga paga neto në shumën 886.426 lekë + shpërblime dhe taksa e solidaritetit në shumën 438.867 lekë. Në total në shumën 1.325.293 lekë; për periudhën 05.12.2003 -18.09.2006: të ardhura nga paga neto në shumën 2.392.075 lekë + shpërblime dhe taksa e solidaritetit në shumën 496.575 lekë. Në total në shumën 2.888.650 lekë.

- Për periudhën Korrik 2002 - Dhjetor 2003 subjektit i është kërkuar të dorëzojë dokumentacion justifikues në lidhje me të ardhurat e përfituara nga punësimi i tij, i cili u administrua nga trupa dhe rezultoi të jetë në vlerën 296.486 lekë për periudhën korrik – dhjetor 2002 dhe 620.327 lekë për periudhën janar-dhjetor 2003, sipas vërtetimit për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare nga DPPSH.
- Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare datë 27.10.2023 nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, për periudhën 01.07.2002 – 05.12.2003.
- Vërtetim mbi bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, me punëdhënësin Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, datë 26.12.2019, që konfirmon se për periudhën prill 2011 - nëntor 2013, ka përfituar të ardhura nga paga neto në shumën 2.155.267 lekë, si dhe të ardhura të tjera nga shpërblimet dhe ditë festash, në shumën 31.818 lekë dhe Vërtetim mbi bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare nxjerrë nga sistemi, me punëdhënësin Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit Korçë, që konfirmon se për periudhën maj 2011 - prill 2018, ka përfituar të ardhura nga paga neto në shumën 6.515.402 lekë. Bashkëlidhur dokumenti i borderove për periudhën 06.05.2011- 16.12.2013.
- Vërtetim me nr. ** prot., datë 12.04.2018, nga ISSH, Drejtoria Rajonale Korçë, që vërteton se z. Arben Joco, ka përfituar të ardhura nga pensioni i parakohshëm i ushtarakut, nga data 01.07.2009 - 31.03.2011, në shumën 384.363 lekë.
- ✓ **Të ardhurat neto të subjektit nga pagat, shpërblime, reforma, etj., për periudhën korrik 1984 - mars 2023, të dokumentuara janë në shumën rreth 20.477.800 lekë.**
- ✓ **Të ardhura neto të subjektit dhe personave të lidhur me të nga interesat bankarë ndër vite janë gjithsej rreth 1.024.600 lekë.**

DETYRIME FINANCIARE

1. Shtetasit P. S. G. i kam marrë borxh 6.000 (gjashtëmijë) euro, për mjekim jashtë shtetit, Turqi. Shuma 6.000 euro.
2. Shtetasit E. Xh. L. i kam marrë borxh 2.000 (dymijë) euro për mjekim jashtë shtetit. Turqi. Shuma 2.000 euro.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

3. BKT, me shkresë me nr. ** prot., datë 09.05.2023, konfirmon se shtetasja Marika Dhimitër Joco ka llogari rrjedhëse, ku janë kryer transferta si vijon: në llogari ka transferuar shumën 960.210 lekë me përshkrimin: kalim sipas kushteve të punës për depozitë të re. Në datë 19.5.2022 ka tërhequr nga llogaria rrjedhëse shumën 200.000 lekë dhe ka hapur depozitë në shumën 760.210 lekë. Në datë 08.08.2022 ka mbyllur depozitën dhe ka transferuar në

Ilogari rrjedhëse shumën 760.534 lekë. Në datë 08.08.2022 ka tërhequr nga Ilogaria rrjedhëse shumën 460.534 lekë.

4. Subjekti ka sqaruar se huamarrjen ndaj shtetasit P. S. G., në shumën 6.000 euro për mjekim jashtë shtetit në Turqi ka shlyer në vitin 2021, me burim kursimet familjare nga të ardhurat nga pagat.
5. Për huamarrjen ndaj shtetasit E. Xh. L., në shumën 2.000 euro për arsye shëndetësore për mjekim jashtë shtetit në Turqi, nuk ka dorëzuar deklaratë noteriale pranë ILDKPKI-së, pasi ky shtetas, aktualisht ndodhej jashtë shtetit me pushime. Deklarata i është rikërkuar subjektit, i cili e ka paraqitur atë pranë Trupës Vlerësuese në datë 01.12.2023.
6. Huamarrjen në shumën 2.000 euro e ka shlyer në periudhën e viteve 2021 - 2022. Për shlyerjen e pjesës së mbetur të detyrimit, për vitin 2022, si burim ishin tërheqjet e kryera nga bashkëshortja në Ilogarinë e saj në BKT.
7. Në periudhën kur këta shtetas, por edhe shumë kolegë i ofruan ndihmë financiare për kurimin jashtë shtetit në Turqi, subjekti ka qenë në gjendje të rëndë shëndetësore (në gjendje kome) për shkak të infektimit me Covid - 19 dhe ka qenë i pavetëdijshëm. Këto ndihma financiare iu dhanë familjarëve të tij.
8. Burimi i të ardhurave të shtetasve P. G. dhe E. L. ishin kursime familjare nga puna e tyre ndër vite.
9. Për shlyerjen e huamarrjes ndaj shtetasit P.G., në shumën 6.000 euro në deklaratën e interesave private "PV 2021", ka menduar se nuk duhej deklaruar, pasi në datë 31.12.2021, nuk kishte detyrime ndaj këtij shtetasi.
10. Paraqiti:
 - Deklaratë Noteriale me nr. ** rep., dhe nr. ** kol., datë 03.07.2023, në të cilën shtetasi P. G. ka deklaruar se: "Në muajin tetor të vitit 2020 i ka dhënë për arsye shëndetësore, familjarëve të mikut Arben Joco, vlerën prej 6.000 euro, për mjekimin e tij në shtetin Turk, vlerë e cila i është kthyer gjatë vitit 2021".
Bashkëlidhur: Kartë Identiteti e shtetasit P.G., me nr. ID xxx dhe Kartë Identiteti e shtetasit Arben Joco, me nr ID xxx.
11. Gjithashtu subjekti sqaroi se është shtruar me urgjencë në Spitalin e Tiranës "Shefqet Ndroqi" në datë 09.10.2020 për shkak të infektimit me COVID 19 (ditë e premte mbasdite) dhe më pas është nisur për në spitalin HISAR, në Stamboll Turqi, në datë 11.10.2020. Këto ishin ditë pushimi dhe bashkëshortja dhe fëmijët e tij ishin në Tiranë. Bashkëshortja nuk ka kryer veprime në bankë, pasi gjendja shëndetësore e subjektit ishte e rënde dhe filialet e bankave ishin të mbyllura, për arsye se ishin ditë pushimi. Shtetasit P. G. dhe E. L. (miq

të familjes), ishin nisur nga qyteti i Korçës dhe shumat e deklaruara ja dhanë bashkëshortes së subjektit, pa ndonjë afat të përcaktuar dhe në mirëbesim.

12. Paraqiti:

- Deklaratë datë 21.09.2023, nga shtetasi P. G. i datëlindjes 22.07.1962, me Nr. ID xxx, i cili deklaroi në përgjegjësi personale se ka në pronësi një dyqan, të cilin prej vitesh e ka lënë me qira me një vlerë 30.000 lekë në muaj. Deklaroi me vullnet të lirë, në përgjegjësi personale dhe me iniciativën e tij se në datë 09.10.2020, i ka dhënë 6.000 euro për mjekim në Turqi, mikut Arben Joco, i cili u sëmur rëndë me COVID 19".
- Vërtetimin për bazën e vlerësueshme, datë 21.09.2023, me vulë elektronike nga ISSH që konfirmon se znj. M. G. (bashkëshortja e P. G.) me ID xxx ka derdhur kontributet mujore mbi pagën bruto, për periudhën nga muaji janar 2012 deri në muajin qershor 2023.
- Vërtetimin për bazën e vlerësueshme, datë 20.09.2023, me vulë elektronike nga ISSH që konfirmon se z. E. L., me ID xxx ka derdhur kontributet mujore mbi pagën bruto, për periudhën nga muaji shkurt 2014 deri në muajin dhjetor 2021.
- Vërtetimin për bazën e vlerësueshme date 20.09.2023, me vulë elektronike nga ISSH që konfirmon se znj. E. L. (bashkëshortja e E. L.), me ID xxx ka derdhur kontributet mujore mbi pagën bruto, për periudhën nga muaji shkurt 2012 deri në muajin gusht 2023.
- Deklaratë noteriale nr. ** rep., nr. ** kol., datë 29.11.2023, nga shtetasi E. L. i datëlindjes 22.10.1974, me Nr. ID xxx, i cili deklaroi përpara noterit se: *"I ka dhënë shumën prej 2.000 euro Z. Arben Gjergji Joco në vitin 2020 kur ai u infektua me Covid19 dhe u nis për kurim në Turqi. Kjo shumë më është kthyer prej tij."*

13. Bazuar në deklarimin e subjektit si dhe në korrespondencën e administruar nga ILDKPKI, në mënyrë të përmbledhur rezulton se:

Nga huamarrjet në shumën totale prej 8.000 euro në vitin 2020, gjatë vitit 2021 janë shlyer 7.000 euro dhe gjatë vitit 2022 janë shlyer 1.000 euro.

- ✓ **Subjekti ka shlyer huamarrjet në shumën totale 8.000 euro, në periudhën 2021 - 2022, me burim të ardhurat familjare nga pagat dhe pakësim të gjendjes së likuiditeteve të bashkëshortes nga llogaria e saj në BKT. Ka sqaruar dhe ka paraqitur dokumentacion lidhur me huamarrjet.**
- ✓ **Nga analiza financiare e kryer, konstatohet se subjekti ka pasur mundësi financiare të ligjshme për shlyerjen e detyrimeve.**

SHPENZIMET E DEKLARUESHME

1. Të vitit të fundit kalendarik për qira banese, ujë, drita, telefon dhe internet, si dhe të gjitha ato pagesa periodike për kontratat e furnizimit apo pajtimit në emër të subjektit ose personave të lidhur - Periudha 1.1.2022 - 31.12.2022.
2. Shpenzimet të deklarueshme për periudhën janar - dhjetor 2022, janë si vijon: Energji elektrike: 44.481,60 lekë; Ujë: 30.648,90 lekë; Shpenzime celularë unë dhe personat e lidhur me mua, internet + TV: 121.600 lekë. Shpenzimet janë në shumën 196.730,50 lekë.
3. Shpenzime për pagesën e qirasë së shtëpisë, ku jeton djali dhe vajza për gjatë gjithë periudhës së studimit në Tiranë. Shpenzimet janë në shumën 1.100.000 lekë.
4. Shpenzime qiraje për ambientin e ushtrimit të aktivitetit privat "Farmaci" nga bashkëshortja, periudha 1994 deri në 30.09.2009, me pagesë me vlerë 8.000 lekë në muaj. Kontrata e lidhur me DRSH Publik Korçë. Shpenzimet janë në shumën 1.440.000 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Vërtetim datë 27.02.2023, nga Shoqëria Rajonale e Ujësjellës Kanalizimeve Korçë sh.a., që vërteton se z. Arben Joco ishte klient i kësaj shoqërie, me nr. kontratë 651950, me adresë: Lagja 4, Rr. "Stavri Shkurti", obj. 44, Korçë. Klienti i ka shlyer të gjitha detyrimet kundrejt Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizimeve Korçë sh.a., deri në 3.1.2023. Gjatë vitit 2022 klienti ka shlyer detyrime në total në vlerën 28.602,70 lekë. Bashkëlidhur: Listë arkëtimesh për vitin 2022; Informacion nga sistemi i faturimit që konfirmon se abonenti Arben Joco me nr. kontrate 651950, ka shlyer rregullisht detyrimet për periudhën shkurt 2008 - janar 2023.
- Dokument kthim përgjigje me nr. ** prot., datë 09.03.2023 nga ONE Albania sh.a., (Albtelekom), drejtuar z. Arben Joco, në lidhje me shpenzimet e realizuara pranë operatorit One Albania Sha. rezulton se Arben Joco ka të regjistruar numrin 0682262111, të lidhur në datë 05.08.2022 dhe numrin 0682616111, të lidhur në datë 06.09.2022 dhe për vitin 2022, rezultojnë pagesa në shumën 3.351,48 lekë.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

5. FSHU, me shkresën nr. ** prot., datë 22.05.2023, konfirmon se shtetasi me gjeneralitetet Arben Gjergji Joco, për periudhën deri në datë 07.03.2023, referuar të dhënave të sistemit të faturimit, nuk rezulton të jetë abonent dhe të ketë kontratë të furnizimit me energji elektrike.
6. Shtetasit me gjeneralitetet Marika, Sotir dhe Eni Joco, për periudhën deri në datë 07.03.2023, referuar të dhënave të sistemit të faturimit, nuk rezulton të jenë abonent dhe të kenë kontratë të furnizimit me energji elektrike.

7. Subjekti ka sqaruar se objekti për të cilin janë deklaruar shpenzimet për energji elektrike është shtëpia e banimit private me sip. ndërtimi 115.43 m², në lagjen nr. 4, Rr. "Stavri Shkurti", Korçë, në të cilën posedon 50 %. FSHU Dega Korçë, gabimisht ka regjistruar gjeneralitetet: Arben Jaçe.
8. Paraqiti:
 - Vërtetim me nr. ** prot., datë 27.02.2023, nga FSHU, që konfirmon se z. Arben Joco me nr.ID xxx, ka lidhur kontratën me kod: KR0Axxxxxx dhe nuk ka detyrime për faturat e energjisë elektrike;
 - Faturë Tatimore që konfirmon pagesat e energjisë elektrike, për periudhën janar 2022 - dhjetor 2022, në shumën rreth 44.453 lekë.
9. Shoqëria Rajonale UK Korçë sha, me shkresën nr. ** prot., datë 11.05.2023, konfirmon se në sistemin e faturimit, rezulton një shtetas me emrin Arben Joco, me kontratë nr.xxx dhe adresë Lagja 4, Rr. "Stavri Shkurti", obj. 44. Kontrata është çelur në muajin shkurt 2008. Klienti ka shlyer të gjitha detyrimet kundrejt UKRK sh.a.. Sipas historikut të faturimit, rezulton se për vitin 2022 janë paguar 28.545 lekë.
10. Në emrin Marika Joco, rezulton kontratë nr. xxxx dhe adresë Rr. "Viktor Eftimiu obj.44. Kontrata është çelur në muajin mars 2008 dhe është pezulluar në muajin nëntor 2010. Klienti ka detyrime të pashlyera kundrejt UKRK sh.a., në vlerën 672 lekë për periudhën prill 2010 - nëntor 2010. Bashkëlidhur historiku i pagesave.
11. Sotir Joco është klient pranë Shoqërisë Rajonale UK Korçë sh.a.
12. Eni Joco nuk është klient pranë Shoqërisë Rajonale UK Korçë sh.a.
13. 14 Shoqëritë Rajonale të Ujësjellës - Kanalizime, nuk konfirmojnë kontrata të lidhura nga subjekti Arben Joco dhe personat e lidhur me të.
14. Subjekti ka sqaruar se për detyrimin e pashlyer në vlerën 672 lekë nga Marika Joco, sipas kontratës nr. 750700 me UK Korçë, për periudhën mars 2008 - nëntor 2010, me adresë Rr. "Viktor Eftimiu", obj. 44, bashkëshortja e tij nuk kishte dijeni dhe ishte detyrim i prapambetur nga aktiviteti tregtar si Person Fizik "Farmaci" dhe ky detyrim u shlye nga bashkëshortja Marika Joco.
15. Djali i subjektit Sotir Joco nuk është klient pranë UK Korçë.

Paraqiti:

- Faturë Tatimore datë 06.07.2023, që konfirmon shlyerjen e detyrimit nga bashkëshortja Marika Joco ndaj UK Korçë, në shumën 672 lekë.
 - Vërtetimin datë 07.07.2023, nga Shoqëria Rajonale UK Korçë, që konfirmon se djali i subjektit Sotir Joco, nuk është klient pranë UK Korçë.
16. Vodafone Albania sh.a., me shkresën nr. ** prot., datë 14.07.2023, përcjell CD që konfirmon se:
Arben Joco ka të regjistruar 1 (një) numër celulari nga data 28.04.2011, me status aktiv dhe për vitin 2022, rezultojnë pagesa në shumën 6.000 lekë;
Marika Joco, e datëlindjes 02.07.2010, ka pasur të regjistruar 1 (një) numër celulari nga data 2.7.2010, e cila ka kaluar me status inaktiv, në datë 11.12.2020.
Sotir Joco, i datëlindjes 06.09.1994 ka të regjistruar 1 (një) numër celular nga data 11.02.2020, me status aktiv dhe për vitin 2022 rezultojnë pagesa në shumën 3.300 lekë;
Eni Joco, e datëlindjes 23.08.2000 ka të regjistruar 2 (dy) numra celulari në datat 17.02.2020 dhe 19.10.2022 me status aktiv dhe për vitin 2022, rezultojnë pagesa në shumën 18.180 lekë. Gjithashtu ka pasur të regjistruar edhe 2 (dy) numra celulari në datat 30.7.2019 dhe 24.8.2019, të cilat kanë kaluar me status inaktiv, në datat 30.10.2020 dhe 24.11.2020.
17. One Albania sh.a., me shkresën nr. ** prot., datë 01.08.2023, përcjell CD që konfirmon se:
Arben Gjergji Joco, ka të regjistruar numrat celularë ONE Albania: 068xxx; 068xxx. Totali i shpenzimeve për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022 është: për numrin 068xxx - 3.352.15 lekë me TVSH; për numrin 068xxx - 3.352.15 lekë me TVSH.
Eni Arben Joco, ka të regjistruar numrat celularë ONE Albania: 068xxx; 068xxx; 068xxx. Totali i shpenzimeve për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022 është: për numrin 068xxx - 8.900 lekë me TVSH; për numrin 068xxx - 1.350 lekë me TVSH.
Shtetasit: Marika Dhimitër Joco dhe Sotir Arben Joco, nuk rezultojnë të regjistruar për shërbimin e telefonisë mobile, telefonisë fikse/internet në rrjetin ONE Albania.
18. Albania Satellite Communications shpk, me shkresën nr. ** prot., datë 15.05.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti Arben Joco dhe personat e lidhur me të.
19. Abissnet sh.a., me shkresën nr. ** prot., datë 11.05.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti Arben Joco dhe personat e lidhur me të.
20. Digicom sh.a., me shkresën nr. ** prot., datë 12.05.2023, konfirmon se Arben Gjergji Joco dhe personat e lidhur me të nuk kanë marrë shërbime interneti nga shoqëria Digicom, për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022.
21. Subjekti sqaroi se pagesat për shërbimet celulare, internet dhe tv, janë bërë në sportelet përkatëse.
22. Për numrin e tij celular me Vodafone Albania sh.a, shpenzimi për vitin 2022 ishte në shumën 6.000 lekë dhe pagesat janë bërë nga llogaria e pagës në Tirana Bank.

23. Djali Sotir Joco ka të regjistruar numër celular me Vodafone Albania dhe për vitin 2022 ka shpenzuar shumën 3.300 lekë.
24. Vajza Eni Joco ka të regjistruar 2 (dy) numra celularë me Vodafone Albania dhe për vitin 2022 ka shpenzuar shumën 18.180 lekë.
25. Subjekti dhe bashkëshortja e tij Marika Joco kanë lidhur kontratë edhe për 2(dy) numra me One Albania sh.a, në muajin shtator 2022 dhe për periudhën deri në 31.12.2022 kanë paguar secili shumën 3.351 lekë.
26. Në total shpenzimet për vitin 2022 për celular, internet dhe tv ishin në shumën rreth 54.819 lekë. Vlera e deklaruar për shpenzimet për celularë, internet dhe tv, në shumën 121.600 lekë për vitin 2022 është lapsus në deklaram, pasi kjo vlerë është deklaruar duke përfshirë edhe shpenzimet për energji elektrike dhe ujë.
27. Paraqiti:
- Kontratë për shërbimin tv, internet dhe telefon fiks të lidhur nga vajza Eni Joco me Vodafone Albania sh.a., që konfirmon pagesën mujore në shumën 1.999 lekë në muaj ose 23.988 lekë në vit.
 - Shkresë me nr. ** prot., datë 09.03.2023 për kontratën e lidhur me ONE Albania sh.a, për numrat celularë të Arben Joco dhe Marika Joco.
28. Subjekti sqaroi se për shpenzimet e deklaruara në shumën rreth 1.100.000 lekë për qiratë e banesave, ku kanë jetuar djali dhe vajza gjatë periudhës së studimeve në Tiranë, nuk dispononte kontrata qiraje, pasi fëmijët e tij kanë jetuar me studente të tjerë dhe bënë pagesën e qirasë për pjesën e tyre takuese. Këto shpenzime të qirave ishin për periudhën e viteve 2013 - 2021 dhe ata kanë ndryshuar disa herë banesën e qëndrimit. Nuk kanë detyrime të pashlyera për tatimin mbi të ardhurat e qirasë, pasi detyrimin për shlyerjen e tatimit mbi të ardhurat e qirasë e kishte qiradhënësi. Nuk dispononte dokumente justifikues lidhur me këtë fakt.
29. Në vitin 2022 fëmijët Sotir Joco dhe Eni Joco kanë jetuar në shtëpinë në Korçë, pranë familjes dhe nuk kanë pasur shpenzime veçmas për energjinë elektrike dhe ujë, si dhe nuk kishin shpenzime qiraje.
30. Për shpenzimet e deklaruara në shumën 1.440.000 lekë për qiranë e ambientit në të cilin bashkëshortja Marika Joco ka ushtruar aktivitetin privat "Farmaci", kanë bërë kërkesë për të dokumentuar shpenzime nga Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Korçë, por ky institucion nuk dispononte kontratë të lidhur nga DRSH Korçë, pasi ka kaluar koha prej 10 vjet e mbajtjes në arkivë. Shpenzimet e qirasë së ambientit me adresë Lagjen 15, Rr.

"Viktor Eftimiu", në të cilin subjekti Marika Joco ka ushtruar aktivitetin privat "Farmaci" ishin shpenzime të biznesit dhe janë deklaruar në organet tatimore.

31. Paraqiti:

- Kthim përgjigje me nr. ** prot., datë 07.07.2023 nga NJVKSH Korçë, që konfirmon se nga kontaktet me personelin e institucionit ka rezultuar se subjekti "Marika Joco" ka pasur kontratë me DRSH Korçë dhe ka kryer derdhjet në arkën e tij në lidhje me marrëdhënien me qira të ambientit në Lagjen 15, Rr. "Viktor Eftimiu". Bashkëlidhur: Skica e ambientit të marrë me qira nga bashkëshortja Marika Joco.
- 32. Subjekti sqaroi se gjatë gjithë periudhës që ka punuar si drejtues policie në qarqe të ndryshme të vendit, ka banuar pranë ambienteve që i janë vënë në dispozicion brenda këtyre Drejtorive të Policisë. Për periudhën 06.04.2011 deri 27.04.2017, kur subjekti ka mbajtur funksione pranë DPPSH-së, ka sqaruar se është akomoduar në një ambient pranë Akademisë së Sigurisë, Tiranë ku ka ndarë dhomën e qëndrimit me një koleg i cili ka qenë i punësuar si Shef Sektori pranë kësaj Akademie, adresë të cilën subjekti e ka deklaruar edhe në historikun e adresave për dhjetë vitet e fundit në deklaratën e kontrollit të figurës.
- 33. Djali Sotir Joco, për periudhën nga data 13.12.2022, që filloi punë në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë deri në 31.12.2022, ka kryer lëvizje vajtje - ardhje në Korçë dhe nuk ka marrë apartament banimi me qira. Në vitin 2023, subjekti ka marrë një apartament me qira, në të cilin banon së bashku me djalin.
- 34. Shpenzimet për ujë + drita + telefoni + internet + tv, gjatë periudhës së sipërcituar janë në shumën 142.000 lekë.
- 35. Subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me udhëtimet private, personale apo të personave të lidhur jashtë territorit shqiptar gjatë 3 viteve të fundit (kalendarike), duke specifikuar shtetin, vendin e qëndrimit, kohëzgjatjen dhe shpenzimet e përballuara - Periudha 01.01.2020 - 31.12.2022.
- 36. Gjatë muajit tetor, e konkretisht me datën 11.10.2020, jam dërguar për mjekim shëndetësor në Turqi. Kam qëndruar i shtruar për rreth 21 ditë në spitalin HISAR, në Stamboll. Një pjesë e vlerës është siguruar nga kontributi i shokëve e kolegëve të mi, në Departamentin e Policisë Kufitare. Pjesa tjetër nga kursimet familjare. Gjithsej 20.350 euro. Një pjesë është marrë borxh rreth 8.000 euro. Shpenzimet janë në shumën 28.350 euro.
- 37. Subjekti sqaroi se në datë 11.10.2020 është dërguar me urgjencë për mjekim në spitalin HISAR, në Stamboll Turqi, pasi ishte infektuar me Covid - 19 dhe ka qëndruar i shtruar në spital rreth 21 ditë. Në vlerën e shpenzuar prej 28.350 euro, nga kontributi i shokëve dhe kolegëve në Departamentin e Policisë Kufitare, ka siguruar shumën rreth 17.000 euro. Lidhur me këtë fakt nuk ka ruajtur listë të pagesave të kryera prej tyre. Kjo shumë bashkë

me kursimet e familjarëve në shumën rreth 3.350 euro dhe huamarrjet në shumën 8.000 euro, plotësuan vlerën e shpenzuar në shumën rreth 28.350 euro, e cila u pagua për mjekimin e subjektit.

38. Në vlerën e shpenzuar në shumën rreth 28.350 euro, përfshihet pagesa e shumës prej 11.800 euro për transportin me avion charter, vlerë e cila është paguar cash që në momentin e nisjes, ndërsa pjesa tjetër prej rreth 17.000 euro është paguar për spitalin HISAR, në Stamboll Turqi. Nga kjo shumë rreth 10.000 euro janë sjellë nga djali kur erdhi në Turqi dhe rreth 7.600 euro janë transferuar nga llogaria e djalit me kreditimet e kryera nga J. M., bashkëshortja e djalit të tezes së subjektit, punonjëse në Credins Bank.

39. Paraqiti:

- Dokumentin nga sistemi TIMS që konfirmon daljen e subjektit në datë 11.10.2020 dhe kthimin e tij në datë 03.11.2020;
- Kërkesën me e-mail datë 18.07.2023, dërguar spitalit HISAR, në Stamboll Turqi për të konfirmuar vlerën e shpenzuar në muajin tetor 2020, në shumën 28.350 euro, për të cilën nuk ka marrë përgjigje.
- Subjekti është ri pyetur në lidhje me dokumentin që vërteton shpenzimet e kryera në spitalin HISAR-Turqi, dhe me shkresën kthim përgjigje nr. ** prot., datë 06.12.2023 ka sqaruar se: “Pavarësisht kërkesave të përsëritura nga ana ime Spitalit HISAR Stamboll-Turqi, nuk më është kthyer ende një përgjigje. Sapo të kem një përgjigje nga ana e tyre, do t’ua vendos menjëherë në dispozicion.”

40. Subjekti ka sqaruar se gjatë periudhës 2020 - 2022 bashkëshortja Marika Joco nuk ka dalje jashtë shtetit.

41. Djali Sotir Joco në datë 13.10.2020 ka shkuar në Turqi kur subjekti ishte i shtruar në Spitalin Hisar në Stamboll Turqi dhe ka qëndruar deri në daljen nga spitali në datë 03.11.2020. Nuk ka ruajtur fatura të hotelit për qëndrimin e tij në Turqi, por sqaroi se shpenzimet ishin rreth 1.000 euro, të cilat janë mbuluar me të ardhurat familjare.

42. Gjithashtu, gjatë viteve 2021 - 2022 ka patur edhe 6 dalje, konkretisht; në Itali nga 04.04.2022 deri në 07.04.2022, me paketë turistike, shpenzuar rreth 300 euro; në Francë 17.12.2022 deri në 20.12.2022, me paketë turistike, shpenzuar rreth 350 euro; në Greqi, datë 25.12.2021 deri në 27.12.2021; datë 23.02.2022 dhe 09.08.2022, kthyer brenda ditës. Shpenzimet për lëvizjet e djalit në Greqi ishin rreth 300 euro. Gjithashtu ka shkuar 1 herë në Kosovë dhe ka shpenzuar rreth 70 euro.

43. Vajza Eni Joco ka patur 2 dalje; në Itali për periudhë 5 ditore nga data 28.09.2021 deri në 03.10.2021 dhe ka shpenzuar rreth 500 euro; në Maqedoni në datë 20.04.2022 është kthyer brenda ditës dhe shpenzimet ishin 50 euro.

44. Nuk kanë ruajtur fatura për shpenzimet e tyre për lëvizjet jashtë shtetit.

45. Gjithashtu subjekti ka kryer edhe lëvizje të tjera jashtë Republikës së Shqipërisë, të cilat kanë qenë vetëm për takime pune me policitë homologe. Konkretisht: në datë 17.09.2020 në Greqi, për takim pune dhe është kthyer brenda ditës; në datë 21.10.2021 në Podgoricë, Mal i Zi, për takim pune dhe është kthyer brenda ditës; në datë 10.11.2021 në Budva, Mal i Zi, për takim pune dhe është kthyer në datë 12.11.2021; në datë 31.11.2021 në Budva, Mal i Zi, për takim pune dhe është kthyer në datë 02.12.2021; në datë 23.06.2022 në Ulqin, Mal i Zi, për takim pune dhe është kthyer brenda ditës.

46. Paraqiti:

- Dokumentin nga sistemi TIMS, që konfirmon daljet e familjarëve për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2022.
- Dokumentin nga sistemi TIMS, që konfirmon daljet e tij për takime pune për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2022.

47. Subjekti sqaroi se kolegu Behar Tafa, me detyrë Asistent i Drejtorit të Departamentit për Kufirin dhe Migracionin është angazhuar në atë periudhë me iniciativën e tij, për të mbledhur kontribute nga kolegët, si ndihmë për përballimin e shpenzimeve të mjekimit në spitalin HISAR, në Stamboll Turqi.

48. Paraqiti:

- Deklaratë nga shtetasi Behar Tafa, i datëlindjes 23.02.1969, me nr. personal xxx, me detyrë Asistent i Drejtorit të Departamentit për Kufirin dhe Migracionin, i cili deklaroi me vullnet të lirë dhe nën përgjegjësinë personale, se: "Nga ana ime në 09.10.2020 janë mbledhur, si kontribut i personelit nga Departamenti për Kufirin dhe Migracionin dhe Drejtorive Vendore për Kufirin dhe Migracionin, rreth 17.000 euro, për kurimin në Turqi të kolegut Arben Joco, në atë kohë Drejtor i Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Gjirokastër, i cili ishte sëmurë rëndë nga COVID 19.
- Në lidhje me këtë deklaratë të shtetasit Behar Tafa, është kërkuar nga ana e Trupës të saktësohet dhe të sqarohet se për sa kohë është mbledhur shuma prej 17.000 euro dhe sa afërsisht kanë qenë në numër kontribuesit për këtë shumë.
- Lidhur me sa është kërkuar shtetasi Behar Tafa në datë 05.12.2023 ka deklaruar se:

“Iniciativa për mbledhjen e donacioneve për kurimin e kolegut tonë, Arben Joco, është ndërmarrë me datën 09.10.2020, kur jemi njoftuar për gjendjen e tij të rëndë shëndetësore dhe nevojën urgjente për tu trajtuar jashtë vendit. Siç e kam deklaruar u grumbulluan rreth 17.000 euro, donacione nga personeli i strukturave vendore për kufirin dhe migracionin (7 Drejtori Vendore), nga personeli i Departamentit për Kufirin dhe Migracionin, si dhe kolegë nga strukturat e tjera në DPPSH. Me sa mund të kujtoj pas kaq kohësh, në donacion kanë kontribuar ndërmjet 600 dhe 650 punonjës policie.”

49. Gjithashtu sipas sistemit TIMS, mbi hyrje – daljet në kufi rezulton:

Djali i subjektit, Sotir Joco ka udhëtuar në datat si më poshtë:

07.10.2011-07.10.2011 PKK Qafë Thanë
25.05.2012-25.05.2012 PKK Kapshticë
10.10.2012-10.10.2012 PKK Goricë
19.04.2013-19.04.2013 PKK Qafë Thanë
24.11.2018-24.11.2018 PKK Morina

Vajza e subjektit Eni Joco ka udhëtuar në datat:

17.04.2018-14.04.2018 PKK Qafë Thanë
27.08.2018-27.08.2018 PKK Kapshticë
25.01.2019-26.01.2019 PKK Kapshticë

50. Subjektit i është kërkuar të na bëjë me dije sa kanë qenë shpenzimet e udhëtimit sipas lëvizjeve të mësipërme dhe paraqitjen e dokumentacionit shoqërues justifikues nëse disponon.

51. Në kthim përgjigjet subjekti ka sqaruar: *“Në këto data djali im Sotir Joco në katër daljet e para jashtë territorit, Qafë Thanë, Kapshticë, Gorricë, Qafë Thanë, ka shkuar në Maqedoninë e Veriut dhe në Greqi ekskursion me shkollën, pasi në atë kohë ka qenë nxënës në shkollën e mesme “Kolegj Preka”. Vlera e shpenzimeve me sa kujtoj ka qenë në total, rreth 200 euro. Në datë 24.11.2018 ka shkuar në Prishtinë dhe ka harxhuar një vlerë prej 150 euro. Vajza ime, Eni Joco më datë 17.04.2018 ka shkuar në Strugë/Maqedoninë e Veriut dhe ka shpenzuar rreth 6000 lekë ose rreth 50 euro. Me datë 27.08.2018 dhe 25.01.2019 që ka dalë në Greqi ka shpenzuar rreth 200 euro.”*

✓ **Sipas shpjegimeve të subjektit, shpenzimet për trajtimin e tij mjekësor jashtë shtetit, në vitin 2020, rezultojnë në total rreth 28.350 euro, konvertuar rreth 3.514.833 lekë, me burim kontributin e kolegëve të punës, në shumën rreth 17.000 euro, huamarrje në shumën 8.000 euro dhe kursime familjare, në shumën rreth 3.350 euro.**

- ✓ **Subjekti paraqiti dokumentin që konfirmon kontributin e kolegëve të punës në shumën rreth 17.000 euro.**
- ✓ **Subjekti paraqiti dokumentin që konfirmon hyrje-daljet nga RSH gjatë periudhës 2020 - 2022, të personave të lidhur me të, me shpenzime të deklaruara rreth 2.570 euro.**
- ✓ **Subjekti konfirmon hyrje-daljet nga RSH gjatë periudhës 2011-2019 të personave të lidhur me të, me shpenzime të deklaruara rreth 600 euro**

52. Për arsimin e fëmijëve madhore apo të mitur, apo të personave të lidhur, duke deklaruar fillimin, llojin e institucionit arsimor, emrin e institucionit, pagesat vjetore, si dhe kohëzgjatjen e studimeve, sipas periudhës së përcaktuar në nenin 32, të Ligjit të Vlerësimit - Periudha nga data e fillimit të punës në institucionin e Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore deri në ditën e plotësimit të formularit të deklaramit të pasurisë.

52.1 Shpenzime për studimin e djalit Sotir Joco, në kolegjin "Preka", Korçë, për periudhën 2010 - 2013. Shuma 220.000 lekë.

52.2 Shpenzime për studimin e djalit Sotir Joco, pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti Juridik, për periudhën 2013 - 2019. Shuma 300.000 lekë.

52.3 Shpenzime për studimin e vajzës Eni Joco, pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale. Periudha 2018 - 2021 (baçelori) dhe 2021 - 2023 regjistrimi dhe pagesë Masteri. Shuma 210.000 lekë.

52.4 Shpenzime për programin e shkollës së "Avokaturës" të djalit gjatë viteve 2020 deri 2021. Shuma 150.000 lekë.

52.5 Subjekti sqaroi se për shpenzimet e deklaruara për arsimin e djalit Sotir Joco, pranë kolegjit "Preka", Korçë për periudhën e viteve 2010 - 2013; Fakultetit Juridik për periudhën 2013 - 2019 dhe për programin e shkollës të "Avokaturës" gjatë viteve 2020 - 2021, në shumën totale 670.000 lekë, nuk ka dokumente që vërtetojnë pagesat e kryera.

52.6 Gjithashtu për shpenzimet e deklaruara për arsimin e vajzës Eni Joco në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale për periudhën 2018 - 2021 (Bachelor) dhe 2021 - 2023 (Masteri) në shumën totale 210.000 lekë, nuk ka dokumente që vërtetojnë pagesat e kryera. Vajza e subjektit Eni Joco, studimet e Masterit për Sociologji është duke e kryer pranë Universitetit "Fan Noli" Korçë.

52.7 Paraqiti:

- Diplomë nga Kolegji "Preka" për djalin Sotir Joco;
- Diplomë Bachelor në Drejtësi Universiteti i Tiranës për djalin Sotir Joco;
- Diplomë Master në Drejtësi, Universiteti i Tiranës për djalin Sotir Joco;

- Certifikatë nga Dhoma e Avokatëve të Shqipërisë, për djalit Sotir Joco.
- Diplomë Bachelor në Sociologji Universiteti i Tiranës për vajzën Eni Joco.

52.8 Subjekti sqaroi se shpenzimet për shkollimin e djalit për periudhën e viteve 2010 - 2013 pranë Kolegjit "Preka", Korçë ishin në shumën 60.000 lekë në vit. Për tre vitet akademike 180.000 lekë, pa përfshirë edhe pagesat për shpenzimet e librave të cilat paguheshin te ky kolegji dhe për tre vite ishin rreth 40.000 lekë.

52.9 Paraqiti:

- Vërtetimin me nr. ** prot., datë 20.09.2023 nga Kolegji "Preka", Korçë që konfirmon se shpenzimet për shkollimin e djalit Sotir Joco për periudhën e viteve 2010 - 2013 pranë këtij kolegji ishin në shumën 60.000 lekë në vit.
- ✓ **Shpenzimet e deklaruara për arsimin e fëmijëve gjatë periudhës deri në ditën e plotësimit të formularit të deklaramit të pasurisë rezultojnë në total rreth 880.000 lekë, për të cilat subjekti ka paraqitur dokumentacion justifikues.**

DEKLARIMI I PASURIVE - B/SHORTJA MARIKA JOCO

7. Depozitë në BKT në emër të Marika Joco. Burimi: Nga të ardhurat e aktivitetit privat ndër vite që kam. Vlera 300.000 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Nxjerrje llogarie nga BKT, datë 31.12.2022 që konfirmon se shtetasja Marika Dhimitër Joco ka llogari rrjedhëse dhe në datë 19.05.2022 ka transferuar në llogari shumën 960.210 lekë me përshkrimin: kalim sipas kushteve të punës për depozitë të re. Në datë 19.05.2022 ka tërhequr shumën 200.000 lekë dhe ka hapur depozitë në shumën 760.210 lekë. Në datë 08.08.2022 ka mbyllur depozitën dhe ka transferuar në llogari rrjedhëse shumën 760.534 lekë. Në datë 08.08.2022 ka tërhequr shumën 460.534 lekë dhe ka hapur depozitë në shumën 300.000 lekë.
- Kontratë depozitë me afat, datë 27.02.2023, që konfirmon se shtetasja Marika Dhimitër Joco në datë 08.08.2022 ka hapur depozitë me afat 1 (një) vjeçar, në shumën 300.000 lekë.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

7.1 BKT me shkresë me nr. ** prot., datë 09.05.2023, konfirmon se shtetasja Marika Dhimitër Joco ka depozitë në lekë me gjendje në datë 07.03.2023 në shumën 300.000 lekë. Në llogari

janë kryer transfertat, si vijon: Në datë 27.04.2006 ka derdhur në llogari shumën 200.000 lekë dhe në datë 28.04.2006 ka hapur depozitë në shumën 200.000 lekë; Në datë 01.06.2006 ka transferuar në llogari shumën 300.000 lekë dhe në datë 02.06.2006 ka hapur depozitë me afat 1 (një) mujor në shumën 300.000 lekë. Në datë 03.08.2006 ka mbyllur depozitën dhe ka tërhequr nga llogaria shumën 301.423 lekë; Në datë 04.10.2006 ka mbyllur depozitën duke e transferuar në llogari shumën 202.288 lekë dhe e ka shtuar në shumën 100.000 lekë; Në datë 05.10.2006 ka hapur depozitë me afat 6 (gjashtë) mujor në shumën 302.288 lekë; Në datë 04.10.2007 ka mbyllur depozitën duke e transferuar në llogari shumën 314.205 lekë dhe e ka shtuar në shumën 185.795 lekë; Në datë 04.10.2007 ka hapur depozitë në shumën 500.000 lekë; Në datë 03.10.2008 ka kaluar në llogari shumën 135.000 lekë dhe në datë 07.10.2008 ka mbyllur depozitën dhe ka kaluar në llogari shumën 527.468 lekë; Në datë 07.10.2008 ka hapur depozitë në shumën 662.468 lekë. Në datë 19.05.2022 ka mbyllur depozitën dhe ka transferuar në llogari shumën 960.210 lekë me përshkrimin: kalim sipas kushteve të punës për depozitë të re. Në datë 19.05.2022 ka tërhequr shumën 200.000 lekë dhe ka hapur depozitë në shumën 760.210 leke. Në datë 08.08.2022 ka mbyllur depozitën dhe ka transferuar në llogari rrjedhëse shumën 760.534 lekë. Në datë 08.08.2022 ka tërhequr shumën 460.534 lekë dhe ka hapur depozitë në shumën 300.000 lekë.

7.2 Subjekti sqaroi se llogaria rrjedhëse në BKT, fillimisht kishte të dhënat Marika Dhimitër Pine, mbiemri i vajzërisë së bashkëshortes së tij. Nga llogaria në BKT, bashkëshortja lidhi kontratën me Drejtorinë Rajonale të Sigurimit dhe Kujdesit Shëndetësor Korçë, për kalimin e pagesave të rimbursimit të vlerave të recetave për kreditimet dhe debitimet ndër vite. Në këtë llogari, ajo nuk kishte kryer asnjë lloj veprimi që nga viti 2010. Pas kërkesës nga BKT për përditësimin e të dhënave të llogarisë, e kaloi llogarinë në emrin Marika Dhimitër Joco duke e kthyer në llogari aktive dhe filloi të kryente veprime në këtë llogari.

7.3 Burimi i kreditimeve të kryera nga bashkëshortja Marika Joco në llogarinë në BKT në periudhën 27.04.2006 - 07.10.2008, për krijimin e depozitës në shumën 620.765 lekë, e cila në vijim u bë me gjendje në shumën 960.210 lekë deri në vitin 2022, janë të ardhurat nga puna e saj nga aktiviteti i biznesit "Farmaci", si rezultat i rimbursimit të vlerës së recetave nga DSKSH Korçë, si dhe interesat bankare. Për periudhën 15.05.2003 - 31.12.2007, në llogarinë e bashkëshortes i janë kredituar nga DSKSH Korçë për rimbursim recetash rreth 10.574.889 lekë dhe mesatarisht fitimin nga vlera e rimbursimit në atë periudhë ishte rreth 20 %. Pasi ka transferuar gjendjen e depozitës në shumën 960.210 lekë në llogari në BKT, ka tërhequr në datë 19.05.2022 shumën 200.000 lekë, me qëllim likuidimin e pjesës së mbetur të borxhit prej 1.000 euro ndaj shtetasit E. L., ndërsa në datë 08.08.2022 ka tërhequr shumën 460.534 lekë me qëllim blerjen e automjetit tip Volkswagen Golf, me targa AB xxx DG, në shumën 3.000 euro dhe shpenzime të ndryshme familjare, përfshirë edhe pushime me familjen.

7.4 Depozita me afat 1 (një) mujor në shumën 300.000 lekë, në emrin e bashkëshortes Marika Joco, në datë 02.06.2006, ka të njëjtin burim të ardhurash, pasi këto të ardhura i ka qarkulluar sipas interesave bankare.

7.5 DSKSH Korçë kërkonte që për rimbursimin e recetave, në vitin 2003 hapjen e një llogarie bankare pranë BKT, duke mos i dhënë rëndësi, nëse ishte llogari biznesi apo individuale, ndërsa për BKT nuk ishte e rëndësishme lloji i llogarisë. Ndërsa në vitin 2016 Credins Bank nuk lejonte të hapej llogari individuale për rimbursimin e vlerës së ilaçeve, por kërkonte hapjen e llogarisë së biznesit.

Konstatohet: Depozita në shumën 300.000 lekë është krijuar në vitin 2022, transferuar nga llogaria rrjedhëse e çelur në v. 2006.

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacion e dorëzuar dhe përgjigjen e BKT.**
- ✓ **Nga analiza financiare e kryer, konstatohet se subjekti ka pasur mundësi financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë.**

8. Depozitë në Raiffeisen Bank në emër të Marika Joco. Burimi: Nga të ardhurat e aktivitetit privat ndër vite që kam, në emrin tim "Farmaci". Vlera 2.083.687,91 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Informacion mbi të dhënat e depozitës me afat rinovimi nga Raiffeisen Bank, datë 27.02.2023, që konfirmon se shtetasja Marika Dhimitër Joco ka depozitë me afat 12 mujor, në shumën 2.083.687,91 lekë.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

8.1 Raiffeisen Bank, me shkresë me nr. ** prot., datë 08.05.2023, përcjell CD që konfirmon se shtetasja Marika Joco, në datë 16.02.2006, ka krijuar depozitë në shumën 1.304.759 lekë, e cila në dt. 05.03.2013, kishte gjendje në shumën 3.877.983 lekë. Nga gjendja e krijuar, po në datë 05.03.2013 ka transferuar për Fond Investimi në Raiffeisen Invest shumën 1.829.995 lekë dhe në datë 31.12.2013 gjendja e depozitës në RFZ Bank mbetet në shumën 2.000.000 lekë. Në datë 07.03.2023 gjendja e depozitës është në shumën 2.083.865 lekë.

8.2 Subjekti sqaroi se depozita në Raiffeisen Bank e krijuar në datë 16.02.2006, në shumën 1.304.759 lekë në emrin e bashkëshortes Marika Joco është e mbartur nga llogaria e kursimit që ajo kishte krijuar në ish-Bankën e Kursimeve, sot RFZ Bank. Burimi i krijimit ishin të ardhura si rezultat i kursimeve nga pagat e subjektit në Policinë e Shtetit, por kryesisht të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja Marika Joco nga aktiviteti privat "Farmaci" dhe nga rimbursimet nga DSKSH Korçë.

8.3 Në periudhën e viteve 2003 - 2007 bëheshin rimbursim të recetave një ose dy herë në muaj dhe për periudhën 15.05.2003 - 31.12.2007, i janë kredituar nga DSKSH Korçë rreth 10.574.889 lekë, në llogarinë e saj në BKT. Përveç derdhjeve të kryera nga rimbursimet,

depozita është shtuar edhe si rezultat i normave të interesave bankare, të cilat varionin nga 4.6% - 6.1%.

8.4 Për gjendjen e depozitave në emrin e bashkëshortes Marika Joco deri në vitin 2013, dispononte një pjesë të kontratave të depozitave, për periudhën e viteve 2007 - 2011 që konfirmojnë ndryshimin e gjendjeve të depozitës në Raiffeisen Bank, pas krijimit të depozitës të vitit 2006, në shumën 1.304.759 lekë.

8.5 Në datë 05.03.2013 bashkëshortja Marika Joco, kishte gjendje depozite në Raiffeisen Bank, në shumën rreth 3.900.000 lekë dhe në këtë datë ka transferuar nga gjendja e depozitës në Raiffeisen Bank për Fond Investimi në Raiffeisen Invest shumën 1.829.995 lekë, duke lënë gjendje depozite në Raiffeisen Bank në shumën 2.000.000 lekë. Nga viti 2013 gjendja e depozitës në Raiffeisen Bank është shtuar vetëm nga interesat dhe në datë 07.03.2023 kishte gjendje në shumën 2.083.865 lekë.

8.6 Paraqiti:

- Marrëveshjen për depozitë me afat në Raiffeisen Bank, datë 31.08.2007, që konfirmon shumën e depozituar prej 615.770 lekë me afat 12 mujor dhe normë interesi 4.6%.
- Marrëveshjen për depozitë me afat në Raiffeisen Bank, datë 16.02.2008, që konfirmon shumën e depozituar prej 1.503.900 lekë, me afat 12 mujor dhe normë interesi 5.4%.
- Kontratë depozite me afat në Raiffeisen Bank, datë 16.02.2009, që konfirmon depozitë në shumën 1.600.000 leke, me afat 12 mujor dhe normë interesi 6.1%.
- Kontratë depozite me afat në Raiffeisen Bank, datë 1.09.2009, që konfirmon depozitë në shumën 852.140 lekë, me afat 12 mujor dhe normë interesi 6.35 %.
- Kontratë depozite me afat në Raiffeisen Bank, datë 16.02.2010, që konfirmon depozitë në shumën 1.700.000 lekë, me afat 12 mujor dhe normë interesi 6.1 %.
- Kontratë depozite me afat në Raiffeisen Bank, datë 02.09.2010, që konfirmon depozitë në shumën 900.840 lekë, me afat 12 mujor dhe normë interesi 5.8 %.
- Kontratë depozite me afat në Raiffeisen Bank, datë 02.09.2011, që konfirmon depozitë në shumën 1.241.198 lekë, me afat 12 mujor dhe normë interesi 4.4%.
- Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank, që konfirmon krijimin e depozitës në Raiffeisen Bank në datë 16.02.2006, në shumën 1.304.758 lekë dhe ndryshimet e saj deri në datë 07.03.2023.

Konstatohet: Depozita në Raiffeisen Bank, në shumën 2.083.687 lekë është krijuar fillimisht në vitin 2006, në shumën rreth 1.304.759 lekë, me burim të ardhurat familjare dhe kryesisht të ardhurat e bashkëshortes nga biznesi "Farmaci".

- ✓ **Konfirmohet depozita në emër të b/shortes në RFZ Bank, me dokumentacionin e paraqitur dhe përgjigjen e bankës.**
- ✓ **Nga analiza financiare e kryer, konstatohet se subjekti ka pasur mundësi financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë.**

**9. Depozitë në fondin e Investimeve në Raiffeisen Bank, në emër të Marika Joco.
Burimi: Të ardhurat nga Aktiviteti. Vlera 2.570.558,61 lekë.**

Bashkëlidhur deklaratës:

- Vërtetim mbi pasqyrën e llogarisë nga Raiffeisen Invest, datë 27.02.2023, që konfirmon se shtetasja Marika Joco ka hapur në vitin 2013 fond investimi dhe gjendja në datë 31.12.2022 është në shumën 2.570.558,61 lekë.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

9.1 Raiffeisen Invest, me shkresë me nr. ** prot., datë 12.05.2023, konfirmon se shtetasja Marika Dhimitër Joco, ka marrëdhënie juridike duke investuar në Fondin Raiffeisen Prestigj që ka filluar në dt. 05.03.2013, në shumën 1.829.995 lekë dhe vazhdon. Në datë 07.03.2023 gjendja në llogari është 2.675.862 lekë.

9.2 Raiffeisen Bank, me shkresë me nr. ** prot., datë 08.05.2023, konfirmon se shtetasja Marika Joco, në datë 05.03.2013 ka kaluar nga llogaria rrjedhëse për Fond Investimi në Raiffeisen Invest, shumën 1.829.995 lekë.

9.3 Subjekti sqaroi se bashkëshortja Marika Joco, nga gjendje e depozitës në Raiffeisen Bank, në shumën rreth 3.900.000 lekë, në datë 05.03.2013 ka transferuar në Fond Investimi në Raiffeisen Invest, shumën 1.829.995 lekë. Shtesa e depozitës në Fondin e Investimeve në Raiffeisen Invest, për periudhën e viteve 2013 - 2023 është nga fitimi i akumuluar nga lëvizja e çmimit të kuotës. Ky fitim është krijuar nga ndryshimet që pësonte çmimi i kuotës që lidhet me çmimin e bursës, si dhe veprimet që bënte banka. Në periudhën e investimit, çmimi për kuotë ishte 1075 lekë, ndërsa në datë 07.03.2023, çmimi për kuotë ishte 1572 lekë. Diferenca përbënte fitimin e akumuluar, pra për një kuotë fitimi është 497 lekë. Në datë 29.06.2023, vlera e depozitës në fondin e investimeve në Raiffeisen Invest ishte bërë 2.736.585,73 lekë dhe për periudhën 3-mujore nga muaji mars 2023 – qershor 2023 është shtuar rreth 60.723,43 lekë. Ky ndryshim varet nga çmimi i kuotës dhe investimi i bankës.

9.4 Paraqiti:

- Urdhër për blerje kuotash nga Fondi i Investimeve tek "Raiffeisen PRESTIGJ", me nr. 7002687342, datë 05.03.2013, në emrin e Marika Joco.
- Vërtetim mbi pasqyrën e llogarisë, datë 05.03.2013, që konfirmon gjendjen e Fondit të Investimit në vlerën 1.829.995 lekë.
- Vërtetim mbi pasqyrën e llogarisë, datë 07.03.2023, që konfirmon gjendjen e Fondit të Investimit, në vlerën 2.675.862 lekë.
- Certifikatën e pronësisë së kuotave datë 29.06.2023, që konfirmon gjendjen e Fondit të Investimit, në vlerën 2.736.585, 73 lekë.

Konstatohet: Depozita në fondin e investimeve RFZ Prestigj, në shumën 2.675.862 lekë është krijuar në vitin 2013, në shumën 1.829.995 lekë, me burim të ardhurat familjare dhe kryesisht të ardhurat e bashkëshortes nga biznesi "Farmaci" dhe më pas nga rritja e çmimit të kuotës.

- ✓ **Konfirmohet depozita në emër të b/shortes në RFZ Invest, me dokumentacionin e paraqitur dhe përgjigjen e bankës.**
- ✓ **Nga analiza financiare e kryer, konstatohet se subjekti ka pasur mundësi financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë.**

10. Llogari rrjedhëse të lidhur me xhiron, rimbursimin e barnave në aktivitetin privat "Farmaci" në Credins Bank, në emër të Marika Joco. Vlera 0 lekë.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

10.1 Credins Bank, me shkresë nr. ** prot., datë 15.05.2023, konfirmon se Marika Joco ka llogari vetëm në cilësinë e Personit Fizik. Kjo shtetase nuk zotëron llogari rrjedhëse individuale për periudhën e kërkuar.

10.2 Subjekti sqaroi se në llogarinë e Marika Joco PF në Credins Bank, për periudhën tetor 2006 - qershor 2018 ka pasur rimbursime nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, në shumën 73.355.847 lekë, ndërsa nga viti 2018 vlera e rimbursuar në llogarinë e Marika Joco është 0 (zero).

Paraqiti:

- Vërtetim me nr. ** prot, datë 01.07.2023 nga Credins Bank Dega Korçë, që konfirmon se për periudhën tetor 2006 deri në qershor 2018, vlera e rimbursimit në llogarinë e Marika Joco është 73.355.847 lekë.
 - Vërtetim me nr. 162 prot, datë 01.07.2023, nga Credins Bank, Dega Korçë, që konfirmon se për periudhën nga viti 2018, vlera e rimbursimit në llogarinë e Marika Joco është 0.
- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e Credins Bank. Llogaria është e aktivitetit të b/shortes, si person fizik.**

DEKLARIMI I TE ARDHURAVE

1. Të ardhura nga aktiviteti privat "Farmaci" në qytetin e Korçës, për periudhën 01.02.1995 deri me 31.12.2002. Në mungesë të dokumentacionit zyrtar dhe referuar xhiros mujore dhe vlerës së rimbursimit janë afërsisht. Shuma 3.000.000 lekë.

2. Të ardhura nga aktiviteti privat "Farmaci" në qytetin e Korçës, për periudhën 01.01.2006 deri më 31.12.2017. Referuar xhiros mujore dhe vlerës së rimbursimit janë të marra nga vërtetimi i DRT Korçë. Shuma 11.080.717 lekë.
3. Të ardhura nga aktiviteti privat "Farmaci" në qytetin e Korçës, për periudhën 01.01.2018 deri më 31.12.2018. Referuar deklaratës 18-A me NIPT K33929020V. Shuma 462.131 lekë.
4. Të ardhura nga aktiviteti privat "Farmaci" në qytetin e Korçës, për periudhën 01.01.2019 deri më 31.12.2019. Referuar deklaratës 19-A me NIPT K33929020V. Shuma 133.360 lekë.
5. Të ardhura nga aktiviteti privat "Farmaci" në qytetin e Korçës, për periudhën 01.01.2020 deri më 31.12.2020. Referuar deklaratës 20-A me NIPT K33929020V. Shuma 236.604 lekë.
6. Të ardhura nga aktiviteti privat "Farmaci" në qytetin e Korçës, për periudhën 01.01.2021 deri më 31.12.2021. Referuar deklaratës 21-A me NIPT K33929020V. Shuma 250.882 lekë.
7. Të ardhura nga aktiviteti privat "Farmaci" në qytetin e Korçës, për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2022. Referuar deklaratës 22-A me NIPT K33929020V. Shuma 416.594 lekë.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

8. ISSH, me shkresë me nr. ** prot., datë 10.05.2023, konfirmon se Marika Joco, për periudhën janar 2012 - mars 2023 ka përfituar të ardhura neto nga paga, nga "Marika Joco" PF me NIPT K33929020V, në shumën rreth 3.293.648 lekë.
9. ISSH, Drejtoria e Arkivit Qendror, me shkresën kthim përgjigje me nr. ** prot., datë 17.05.2023, nuk konfirmon të dhëna për periudhën 1994-2012. Bashkëlidhur dokumentacioni si vijon:
 - Vërtetim për vjetërsinë në punë për efekt pensioni, me nr. ** prot., datë 12.05.2023, që konfirmon se Marika Dhimitër Joco, lindur me 1967, në Ziçisht Korçë, figuron në Rajonin Korçë dhe ka punuar në Degën e Farmacive, për periudhën nga data 21.09.1989 - 21.01.1995.
10. QKB, me shkresën nr. ** prot, datë 08.05.2023, konfirmon se shtetasja Marika Joco figuron e regjistruar si Person Fizik, e pajisur me NUIS (NIPT) K33929020V; Fusha e veprimtarisë: Farmaciste; Data e regjistrimit: 29.03.2003; Adresa: Korçë; Lagja 15, Rr. "Viktor Eftimiu", banesa private nr. 21; Statusi: Aktiv. Nga kontrolli i të dhënave të publikuara në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve për subjektin "Marika Joco" me NUIS (NIPT) K33929020V, rezultojnë: 1) LN-0413-10-2009, Farmacitë ose agjencitë farmaceutike (farmaci), Aktive; 2) Licencë me numër 1546,

Farmacitë ose agjencitë farmaceutike (farmaci), lëshuar jashtë QKB-së me status "Përfunduar afati".

11. DPT, me shkresën nr. ** prot, datë 11.05.2023, konfirmon se shtetasja Marika Dhimitër Joco, figuron e regjistruar në Agjencinë Tatimore Korçë me NUIS (NIPT) K33929020V; Tatimpagues: "Marika Joco"; Roli tek ky tatimpagues: Administratore; e vlefshme nga data: 10.12.2009.
12. DRT Korçë, me shkresën nr. ** prot, datë 15.05.2023, konfirmon se shtetasja Marika Dhimitër Joco, e dtl. 30.07.1967, nr. ID G75730052P është administratore e subjektit "Marika Joco" me NIPT K33929020V, në adresën: Lagja 15, Rr. "Viktor Eftimiu", Korçë, me aktivitet Farmaci, për periudhën 29.03.2003 e në vazhdim. Në lidhje me informacionin e kërkuar, mbështetur në të dhënat e sistemit informatik tatimor të DRT Korçë, rezulton se:
 - **Detyrimet tatimore** lidhur me biznesin janë: Subjekti deri në datën e shkresës ka detyrime tatimore të pa likuiduara në shumën 14.171 lekë.
 - **Xhirot dhe fitimi (humbje) e deklaruar ndër vite:**

Periudha	Xhiro	Fitimi/Humbja	Tatimi i paguar	Dt.deklarimit
2005	3,508,000		98,032	9.3.2006
2006	6,000,000		90,000	1.3.2007
2008	4,367,580	1,130,000	113,000	27.3.2009
2009	7,240,674	1,130,000	113,000	30.3.2010
2010	6,995,784	1,012,858	101,286	25.3.2011
2011	7,979,496	794,285	79,429	28.3.2012
2012	9,329,932	771,749	77,175	28.3.2013
2013	3,250,174	376,396	37,640	27.3.2014
2014	8,541,448	461,765	69,265	30.3.2015
2015	8,352,272	1,069,241	160,386	30.3.2016
2016	6,316,479	664,629	99,694	9.5.2017
2017	11,636,785	1,477,010	221,552	26.3.2018
2018	5,653,243	462,131	69,320	28.3.2019
2019	1,607,963	133,360	6,668	27.3.2020
2020	1,697,700	243,608	12,180	13.9.2021
2021	1,805,692	250,882		12.3.2022
2022	2,181,943	416,594		27.2.2023

13. Për vitin 2007, subjekti nuk ka deklarim të ardhurash pranë administratës tatimore, pasi deklarimet për këtë periudhë ishin në administrim të organeve vendore.
14. Subjekti i mësipërm është regjistruar me status personi fizik dhe në zbatim të Ligjit nr. 8438, dt. 28.12.1998, nuk ka detyrime për të ndarë dividend.
 - **Konstatohet se:** Të ardhurat e realizuara nga fitimi i aktivitetit "Marika Joco" me NIPT K33929020V, me aktivitet Farmaci në Korçë, për periudhën e viteve 2008 - 2022, rezultojnë në shumën rreth 9.096.000 lekë (fitimi bruto - tatim i paguar).

15. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Korçë, me shkresën nr. ** prot, datë 04.07.2023, konfirmon të jetë i regjistruar subjekti "Marika Joco", me administrator Marika Joco me numër NUIS-i NIPT K33929020V, me aktivitet "Farmaci", me adresë Korçë, Lagja 15, Rr. "Viktor Eftimiu", banesë private nr. 21.
Ky subjekt ka likuiduar tarifatat vendore ndaj bashkisë Korçë, deri në vitin 2023.
16. Siç është trajtuar më lart në pjesën e analizës financiare të krijimit të pasurisë shtëpi banimi të subjektit, të ardhurat e bashkëshortes Marika Joco nga aktiviteti privat "Farmaci" në qytetin e Korçës për periudhën 01.02.1995 deri më 31.12.2002, të cilat referuar xhiros mujore dhe vlerës së rimbursimit janë deklaruar afërsisht në shumën rreth 3.000.000 lekë, nuk ka gjetur dokumentacion nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve, Zyra e Shërbimeve për Tatimpaguesit Korçë.
17. Për periudhën e viteve 1995 - 2002, rezulton se nga verifikimi i regjistrave manualë të ndodhura pranë DSHT është gjetur informacioni si vijon: Për vitin 1998 - Marika Dhimitër Joco me kod fiskal 160654, me objekt aktiviteti Farmaci me adresë L. 4, Rr. "N. Kapo", nr. 4, me paradhënie tatimi 50.000 lekë; Për vitin 2002 - Marika Dhimitër Joco me kod fiskal 1606544, me objekt aktiviteti Farmaci me adresë L. 14, Rr. "V. Eftimiu", me paradhënie 60.000 lekë.
18. Nga verifikimet i të gjithë regjistrave manualë që ndodhen në Zyrën e Shërbimit për Tatimpaguesit në DSHT Korçë, nuk është gjetur informacion për subjektin Marika Joco me NIPT K33929020V për vitet 2003 - 2004.
19. Nga sistemi Cats, për vitet 2005 - 2006 të dhënat janë si vijon:
- Viti 2005: xhiro 3.508.000 lekë; fitimi/humbja - tatimi i paguar 98.032, datë 09.03.2006;
 - Viti 2006: xhiro 6.000.000 lekë; fitimi/humbja - tatimi i paguar 90.000; datë 01.03.2007.
 - Në vitin 2007 Marika Joco ishte e regjistruar pranë Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore me NIPT K33929020 për aktivitetin Farmaci me adresë Lagja nr. 15, Rr. "Viktor Eftimiu", banesë private nr. 21 dhe taksa vendore për vitin 2007 i janë llogaritur mbi qarkullimin vjetor të parashikuar 6.000.000 lekë - 7.000.000 lekë, respektivisht 113.000 lekë.
20. Të ardhurat e konfirmuara nga ISSH, janë të ardhurat nga pagat neto të bashkëshortes nga puna në subjektin tregtar "Marika Joco" PF me NIPT K33929020V.
21. Subjekti paraqiti:
- Dokument kthim përgjigje nga DRT Korçë, me shkresën nr. ** prot, datë 06.07.2023, që konfirmon se shtetasja Marika Dhimitër Joco është e regjistruar si administratore e subjektit "Marika Joco" me aktivitet Farmaci me NIPT K33929020V, në adresën: Lagja 15, Rr. "Viktor Eftimiu", Korçë. Për periudhën e viteve 1995 - 2002, rezulton se nga verifikimi i regjistrave manualë të ndodhura pranë DSHT është gjetur informacioni si

vijon: Për vitin 1998 - Marika Dhimiter Joco me kod fiskal 160654, me objekt aktiviteti Farmaci me adresë L. 4. Rr. "N. Kapo", nr. 4, me paradhënie tatimi 50.000 lekë; Për vitin 2002 - Marika Dhimitër Joco me kod fiskal 160654, me objekt aktiviteti Farmaci me adresë L. 14, Rr. "V. Eftimiu", me paradhënie 60.000 lekë.

- Formular i deklarimit dhe pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për vitin 2005 për Marika Joco, me xhiro 3.508.000 lekë; tatimi i paguar 98.032 lekë.
- Formular i deklarimit dhe pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për vitin 2006 për Marika Joco me xhiro 6.000.000 lekë; tatimi i paguar 90.000 lekë.
- Vërtetim me nr. ** prot., datë 07.07.2023, që konfirmon se Marika Joco është e regjistruar pranë Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore me NIPT K33929020V për aktivitetin Farmaci, të cilin e ushtron në adresën: Lagjja nr. 15, Rr. "Viktor Eftimiu", banesë private nr. 21. Taksa Vendore për vitin 2007 i është llogaritur mbi qarkullimin vjetor të parashikuar 6.000.000 lekë - 7.000.000 lekë, respektivisht 113.000 lekë.
- Nxjerrje llogarie nga BKT, datë 29.06.2023, që konfirmon se bashkëshortja e subjektit, Marika Joco ka hapur llogarinë rrjedhëse në datë 22.04.2003 dhe për periudhën 15.05.2003 - 31.12.2007 i janë kredituar nga DSKSH Korçë, për likuidim faturash rreth 10.574.889 lekë. Evidentohen gjithashtu, pagesa të kryera nga Marika Joco (Pine) për tatim fitimin, sigurimet shoqërore e shëndetësore, taksa vendore etj., që nga viti 2003 për aktivitetin e biznesit me NIPT K33929020V.
- Vërtetim me nr. ** prot, datë 01.07.2023 nga Credins Bank Dega Korçë, që konfirmon se Marika Joco ka llogari si person fizik dhe për periudhën tetor 2006 - qershor 2018 vlera e rimbursimeve nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor ishte në shumën 73.355.847 lekë.

Konstatohet se: QKB konfirmon regjistrimin e aktivitetit të b/shortes "Farmaci" me NIPT K33929020V në mars 2003, ndërsa DRT Korçë nga regjistrat manualë jep informacion edhe për vitin 1998 dhe 2002 për aktivitet me kod fiskal 160654.

Gjithashtu, nga statementet bankare të Marika Joco evidentohen kryerje të pagesave nga dhe në favor të DRSKSH Korçë gjatë kësaj periudhe, për biznesin person fizik.

✓ **Të ardhurat të biznesit "Marika Joco" Person Fizik me NIPT K33929020V:**

- për periudhën 2005 - 2006, DRT Korçë konfirmon xhiro 9.508.000 lekë dhe tatim fitimi në shumën 188.032 lekë.
- për vitin 2007 konfirmohet nga Bashkia Korçë pagesë takse në shumën 113.000 lekë, llogaritur mbi xhiron vjetore në shumën 6.000.000 - 7.000.000 lekë.
- për periudhën 2008 - 2022 konfirmohet nga DRT Korçë, fitimi në shumën rreth 9.096.000 lekë (fitimi bruto - tatim i paguar).
- për periudhën janar 2012 - mars 2023, konfirmohet nga ISSH paga e b/shortes si administratore, në shumën rreth 3.293.000 lekë.
- për periudhën 1995 - 2002, deklarohen të ardhura nga biznesi i b/shortes në shumën 3.000.000 lekë, për të cilat disponimi i dokumentacionit justifikues ligjor është trajtuar më

lart. Nga ana e Trupës Vlerësuese për periudhën 1998-2004, është marrë në konsideratë shuma prej 2.520.000 lekësh si realizim të ardhurash (fitim pas tatimit) nga aktiviteti farmaci gjë e cila është trajtuar më lart tek analiza financiare e krijimit të pasurisë shtëpi banimi të subjektit.

- Të ardhurat nga biznesi i b/shortes kanë shërbyer si burim krijimi për depozitën në shumën rreth 1.300.000 lekë në emër të saj në RFZ Bank, në vitin 2006 (nga e cila e kanë origjinën depozitat e deklaruara në RFZ Bank dhe RFZ Invest deri në datën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë).

DEKLARIMI I DJALIT TE SUBJEKTIT - SOTIR JOCO

DEKLARIMI I PASURIVE

- 11. Autoveturë tip Mercedes Benz, viti i prodhimit 2004, me targa AA xxx JK, blerë në vitin 2014. Burimi: Blerë nga kursimet dhe të ardhurat e familjes. Vlera 4.000 euro. Zotëron 100%.**

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

11.1 DPSHTRR, me shkresë me nr. ** prot., datë 12.05.2023, konfirmon se Sotir Arben Joco me numër ID xxx, ka të regjistruar automjetin me targa AA xxx JK, i markës DAIMLER CHRYSLER, me numër shaspie xxxx, blerë me kontratë shitje nr. ** rep., dhe nr. ** kol., datë 29.08.2014, në vlerën 500.000 lekë, me palë shitëse shtetasin Arben Gjergji Joco. Arben Gjergji Joco, me numër ID xxx, ka blerë automjetin e markës DAIMLER CHRYSLER, me numër shaspie xxxx, me kontratë shitje datë 21.08.2014, në vlerën 1.500 euro, me palë shitëse HAGMAYER UND RENNER GMBH. Automjeti rezulton i ardhur nga Gjermania dhe vlera e paguar për çdoganimin është në shumën 55.421 lekë. Bashkëlidhur dosja e automjetit me targa AA xxx JK.

11.2 Subjekti sqaroi se deklarimi i vlerës së blerjes së automjetit të markës DAIMLER CHRYSLER, me targa AA xxx JK nga djali Sotir Joco, është lapsus në deklaram, pasi vlera e këtij automjeti në kontratën e shitblerjes është 500.000 lekë. Ky automjet është blerë nga subjekti në datë 21.08.2014, në vlerën 4.000 euro, që në atë kohë konvertohej në vlerën rreth 500.000 lekë. Automjetin e markës DAMLER CHRYSLER me targa AA xxx JK, e kaloi në pronësi të djalit Sotir Joco me kontratë shitblerje datë 29.08.2014.

- 11 Për vlerën e vendosur në kontratën e shitblerjes së kryer prej tij, në datë 21.08.2014 në shumën 1.500 euro, sqaroi se nuk ka qenë i kujdesshëm kur ka nënshkruar kontratën dhe nuk e ka parë vlerën e vendosur në kontratë, por theksoi se shitësit i ka paguar shumën 4.000 euro.
- 12 Nuk ka pasur fitime të ardhurash nga blerja dhe shitja e këtij automjeti. Ky automjet ka ardhur nga Gjermania dhe zhdoganimi në shumën 55.421 lekë është paguar nga subjekti.

- ✓ **Konstatohet:** Automjeti tip Daimler Chrysler është blerë nga subjekti në vitin 2014 dhe po këtë vit i është shitur djalit të tij. Sipas kontratave të paraqitura, automjeti është blerë nga subjekti në shumën 1.500 Euro dhe i është shitur djalit në shumën 500.000 lekë. Ka deklaruar dhe sqaruar për vlerën e automjetit në shumën 4.000 Euro.
- ✓ **DPSHTR konfirmon automjetin në pronësi të djalit Sotir Joco, me vlerë 500.000 lekë.**
- ✓ **Nga analiza financiare e kryer, konstatohet se subjekti ka pasur mundësi financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë.**

DEKLARIMI I TE ARDHURAVE

1. Të ardhura nga paga neto nga puna e kryer pranë kompanisë së "IMS" Tiranë, me pozicion pune Operative, që nga periudha janar 2017 deri më maj 2018. Shuma 4.432 euro.
2. Të ardhura nga paga neto nga puna e kryer pranë kompanisë së "IMS" Tiranë, me pozicion pune Operative, që nga periudha 24.05.2018 deri me 31.01.2019. Shuma 2.990 euro.
3. Të ardhura nga paga nga 01.10.2021 - 31.12.2021. Nga studio Avokaturë N. V. Shuma 82.000 lekë.
4. Të ardhura nga paga neto nga 13.12.2022, deri në periudhën e deklarimit, në institucionin e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë (Jurist). Shuma 93.882 lekë.
Bashkëlidhur deklaratës:
 - Nxjerrje llogarie nga Credins Bank, datë 27.02.2023, që konfirmon se Sotir Joco ka llogari rrjedhëse në lekë dhe për periudhën 05.11.2021 - 07.01.2022, i janë kredituar në llogari nga N. V. PF, të ardhura neto nga paga në shumën rreth 76.287 lekë.
Për periudhën 06.01.2023 - 02.02.2023, i janë kredituar të ardhura neto nga paga nga Drejtoria e Policisë Qarkut Tiranë, në shumën rreth 93.882 lekë.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

5. Credins Bank, me shkresën nr. ** prot., datë 15.05.2023, konfirmon se Sotir Joco ka llogari rrjedhëse në lekë dhe për periudhën 05.11.2021 - 07.01.2022 i janë kredituar në llogari nga N. V. PF, të ardhura neto nga paga në shumën rreth 76.287 lekë, ndërsa për periudhën 06.01.2023 - 02.03.2023, i janë kredituar të ardhura neto nga paga nga Drejtoria e Policisë Qarkut Tiranë, në shumën rreth 139.169 lekë. Sotir Joco, ka llogari rrjedhëse në euro dhe për periudhën 16.01.2017 - 21.01.2019 i janë kredituar në llogari të ardhura nga paga nga I. M. S. shpk, në shumën rreth 8.047 euro.

6. ISSH, me shkresë me nr. ** prot., datë 10.05.2023, konfirmon se Sotir Joco, për periudhën shkurt 2017 - dhjetor 2018 ka përfituar të ardhura neto nga paga nga International Marketing Solutions, në shumën rreth 947.409 lekë, ndërsa për periudhën tetor 2021 - mars 2023 ka përfituar të ardhura neto nga paga nga N. V., Transport Highway Consulting dhe Drejtoria e Policisë, në shumën rreth 438.991 lekë.

- ✓ **Të ardhurat neto të djalit nga pagat, për periudhën shkurt 2017 - mars 2023 të konfirmuara nga ISSH, janë në shumën rreth 1.387.000 lekë.**

DEKLARIMI I VAJZËS TË SUBJEKTIT - ENI JOCO

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

1. Të ardhurat e mia nga punësimi në periudhën maj 2022 deri në janar 2023 nga puna si psikologe në shkollën Profesionale Korçë. Shuma 424.800 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Nxjerrje llogarie nga BKT, datë 27.02.2023, që konfirmon se Eni Joco ka llogari page dhe për periudhën 02.06.2022 - 30.12.2022, i janë kredituar në llogari të ardhura neto nga pagat nga Shkolla "Demir Progri" në shumën rreth 315.000 lekë.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

2. BKT, me shkresë me nr. ** prot., datë 09.05.2023, konfirmon se shtetasja Eni Arben Joco, ka llogari rrjedhëse në lekë dhe për periudhën 02.06.2022 - 02.03.2023 i janë kredituar në llogari të ardhura neto nga pagat dhe mbështetje financiare nga Shkolla "Demir Progri" dhe Shkolla e Agrobiznesit "Irakli Ternova" në shumën rreth 476.612 lekë.
3. ISSH, me shkresë me nr. ** prot., datë 10.05.2023, konfirmon se Eni Joco për periudhën maj 2022 - mars 2023 ka përfituar të ardhura neto nga paga nga Shkolla e Mesme Industriale dhe Shkolla e Agrobiznesit, në shumën rreth 492.671 lekë.

- ✓ **Të ardhurat nga pagat e vajzës, për periudhën maj 2022 - mars 2023, të konfirmuara nga ISSH, janë në shumën rreth 493.000 lekë.**

Përveç sa më sipër, subjekti ka b/lidhur:

1. Nxjerrje llogarie nga Credins Bank, datë 27.02.2023, që konfirmon se Sotir Joco ka llogari rrjedhëse në euro dhe për periudhën 12.10.2020 - 16.03.2022 i janë kredituar në llogari nga shtetasja J. M. rreth 7.698 euro. Sotir Joco ka kryer pagesa nga llogaria për Spitalin HISAR Stamboll Turqi dhe pagesa të tjera në shumën totale rreth 7.053 euro.

2. Sotir Joco, ka llogari rrjedhëse në lekë dhe në datë 11.11.2021 është kredituar nga shtetasi J. Q., shuma 44.750 lekë.
3. Nxjerrje llogarie nga Credins Bank, datë 27.02.2023 që konfirmon se Eni Joco ka llogari rrjedhëse në lekë dhe për periudhën 09.07.2018 - 21.11.2022, i janë kredituar nga shtetas të ndryshëm vlera relativisht të vogla, të cilat në total ishin në shumën rreth 275.283 lekë dhe vajza e subjektit Eni Joco ka kryer transferta për blerje on-line.
4. Credins Bank, me shkresën nr. ** prot., datë 15.05.2023, konfirmon se Sotir Joco ka llogari rrjedhëse në lekë me gjendje në datë 07.03.2023 në shumën 37.158 lekë. Në datë 11.11.2021 është kredituar nga shtetasi J. Q. shuma 44.750 lekë.
5. Sotir Joco, ka llogari rrjedhëse në euro me gjendje në datë 07.03.2023, në shumën 1 euro. Në llogari për periudhën 12.10.2020 - 16.03.2022 i janë kredituar nga shtetasja J. M. rreth 7.698 euro, ndërsa djali Sotir Joco ka kryer pagesa për llogari të Spitalit HISAR Stamboll Turqi dhe pagesa të tjera, në shumën totale rreth 7.053 euro.
6. Eni Joco, ka llogari rrjedhëse në lekë me gjendje në datë 07.03.2023, në shumën -60 lekë dhe për periudhën 30.09.2017 - 30.11.2017 ka kredituar në llogari shumën rreth 19.657 lekë.
7. Eni Joco, ka llogari Visa Prepaid Student në lekë, me gjendje në datë 07.03.2023, në shumën 59 lekë dhe për periudhën 09.07.2018 - 21.11.2022, i janë kredituar nga shtetasit Zh. T., J. M., G. T., K. M., R. Xh., dhe Collective shpk, vlera të vogla në shumën totale rreth 275.283 lekë dhe vajza e subjektit Eni Joco ka kryer transferta për blerje on-line.
8. Subjekti sqaroi se gjendja e llogarisë së pagës në emrin e djalit Sotir Joco, në datë 07.03.2023 në shumën 37.158 lekë në Credins Bank është harruar për t'u deklaruar, pasi ishte vlerë relativisht e vogël dhe lehtësisht e verifikueshme.
9. Shtetasi J. Q. është shoku i fëmijërisë i djalit dhe kreditimi i shumës 44.750 lekë në llogarinë e tij ka qenë për blerje pjesë mjeti, që ky shtetas kishte porositur në Tiranë.
10. Shtetasja J. M., punonjëse në Credins Bank, është bashkëshortja e djalit të tezes së subjektit, K. M. Shumat e kredituara prej saj, në llogarinë e Sotir Joco janë me burim nga kontributi i kolegëve të subjektit, të cilët në periudhën kur ishte i sëmurë me Covid 19, ia kanë dhënë bashkëshortes së tij. Për shkak se djali i subjektit u nis me urgjencë në Turqi për të qenë i pranishëm në Spitalin Hisar Stamboll, kreditimet në llogarinë e tij kryheshin nga shtetasja J. M. Këto vlera monetare djali i subjektit i transferonte për pagesa me Spitalin Hisar dhe disa shpenzime personale. Theksoi se burimi i kreditimeve nga shtetasja J. M. ishin një pjesë e kontributit të kolegëve të subjektit për rastin kur ai ishte i sëmurë me Covid 19.

11. Kreditimet në llogaritë e vajzës Eni Joco në Credins Bank nga individë të ndryshëm, për periudhën 09.07.2018 - 21.11.2022, në shumën 275.283 lekë, janë kryer për blerje on-line nga shtetas që janë të afërm të familjes dhe me lidhje miqësore dhe shoqërore me vajzën e subjektit, Eni Joco. Porositë për blerje on-line beheshin nga llogaria e vajzës Eni Joco, e cila nuk disponon fatura blerjesh, pasi nuk i kishte ruajtur. Në këto raste vajza e subjektit ka përdorur llogarinë e saj në Credins Bank.

✓ **Subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me transaksionet në Credins Bank dhe burimin e tyre.**

Gjithashtu:

12. Banka e Shqipërisë, Banka e Bashkuar e Shqipërisë, ProCredit Bank, Banka e Parë e Investimeve, Banka Amerikane e Investimeve, OTP Bank, Raiffeisen Leasing, Porche Leasing, Albania Leasing, Landeslease, Credins Invest, Easypay, Fondi Besa, Institucioni Financiar NOA, Iute Credit Albania, Kredo Finance, konfirmojnë se subjekti Arben Joco dhe personat e lidhur me të nuk janë klientë të tre, ç`ka konfirmohet me deklarinimin.

13. Drejtoritë dhe Zyrat Vendore të ASHK-së, dhe konkretisht: Tirana Veri, Tirana Jug, Zonat e Stimuluara, Tirana Rurale1, Tirana Rurale 2, Librazhd, Mallakastër, Fier, Gjirokastër, Devoll, Lushnjë, Berat, Pogradec, Kukës, Kavajë, Gramsh, Malësi e Madhe, Kuçovë, Kamëz Vorë, Pukë, Peqin, Skrapar, Durrës, Bulqizë, Has, Kolonjë, Elbasan, Mirditë, Tropojë, Tepelenë, Përmet, Mat, Shkodër, Vlorë, Sarandë, Krujë, Kurbin, Dibër, Lezhë, nuk konfirmojnë pasuri të paluajtshme të regjistruara apo në proces legalizimi në emër të subjektit dhe personave të lidhur.

14. Raiffeisen Bank, me shkresë me nr. ** prot., datë 08.05.2023, përcjell CD që konfirmon se Arben Joco dhe Marika Joco, në datë 31.08.2006 kanë hapur depozitë në shumën 452.716 lekë. Në datë 31.08.2007 kanë mbyllur depozitën bashkë me interesa në shumën 466.976 lekë.

Marika Joco, ka pasur llogari rrjedhëse në lekë dhe në datë 01.10.2004 ka transferuar në llogari shumën 992.953 lekë nga teprica që kishte depozitë. Në datë 16.02.2006 ka mbyllur depozitën në shumën 1.004.779 lekë.

Marika Joco, ka pasur llogari rrjedhëse në lekë dhe në datë 02.09.2011 ka hapur depozitë në shumën 1.241.198 lekë me afat 6 mujor dhe në datë 02.03.2012 është mbyllur depozita.

15. Subjekti ka sqaruar se depozita dy emërore e hapur në Raiffeisen Bank, në vitin 2006, në shumën 452.716 lekë është krijuar për lehtësi veprimesh, tërheqje dhe derdhje në bankë. Burimi i krijimit ishin të ardhurat e përbashkëta nga puna, por kryesisht të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja e subjektit Marika Joco nga aktiviteti privat "Farmaci" dhe nga rimbursimet nga DKSH Korçë. Bashkëshortja ka krijuar llogari kursimi në ish Bankën e Kursimeve, sot Raiffeisen Bank nga këto të ardhura. Sqaroi se për periudhën para vitit 2005 është e vështirë për të siguruar dokumentacion justifikues lidhur me te ardhurat,

kryesisht nga fitimi i biznesit të bashkëshortes. Në përgjigjet e pyetjeve të sipërcituara, dorëzoi dokumentacionin justifikues që ka mundur të sigurojë lidhur me të ardhurat.

16. Llogaria në shumën 992.953 lekë në Raiffeisen Bank, në emrin e bashkëshortes Marika Joco, ka qenë gjendje në llogarinë e saj në ish Bankën e Kursimeve, që para vitit 2003 dhe burimi i krijimit është i njëjtë. Trajtuar më sipër.
17. Depozita në shumën 1.241.198 lekë në Raiffeisen Bank, datë 02.09.2011, me afat 6 muajor në emrin e bashkëshortes Marika Joco, e cila rezulton e mbyllur në datë 02.03.2012, ishte krijuar me burim të ardhurat nga aktiviteti i saj privat "Farmaci", rimbursimet nga DKSH Korçë, si dhe interesat bankare. Gjendja e kësaj depozite në datë 02.03.2012 në shumën 1.241.198 lekë është bashkuar me depozitën që bashkëshortja kishte krijuar në vitin 2006 dhe kanë vazhduar deri në datë 07.03.2023, si edhe janë deklaruar.
- ✓ **Subjekti sqaroi burimin e krijimit të depozitave në emrin e bashkëshortes Marika Joco në Raiffeisen Bank, nga të ardhurat e përbashkëta nga puna, kryesisht nga aktiviteti privat "Farmaci" i bashkëshortes Marika Joco. Këto depozita janë pjesë e gjendjeve të depozitave që ka deklaruar në datë 07.03.2023.**
18. BKT, me shkresë me nr. ** prot., datë 09.05.2023, konfirmon se Eni Joco, ka llogari rrjedhëse në lekë, me gjendje në datë 07.03.2023 në shumën 40.879 lekë, si dhe ka llogari kartë krediti në lekë, me limit 40.000 lekë.
19. Subjekti sqaroi se vajza Eni Joco ka llogari rrjedhëse kartë krediti në BKT, me limit 40.000 lekë, të cilën e ka marrë për përdorim vetjak dhe gjendjen e kartës së kreditit nuk e ka përdorur.
- ✓ **Llogaria rrjedhëse e kartës së kreditit në BKT, me limit 40.000 lekë në emrin e vajzës, nuk është përdorur prej saj.**
20. Intesa Sanpaolo Bank, me shkresë me nr. ** prot., datë 19.05.2023, konfirmon se Arben Joco ka llogari rrjedhëse në lekë, me gjendje në datë 07.03.2023, në shumën 13,11 lekë. Arben Joco, ka llogari rrjedhëse në euro, me gjendje në datë 07.03.2023, në shumën 4,90 euro. Arben Joco ka llogari rrjedhëse në usd, me gjendje në datë 07.03.2023, në shumën 4,24 usd.
21. Union Bank, me shkresën nr. ** prot., datë 23.05.2023, konfirmon se Sotir Joco rezulton të jetë klient pranë kësaj banke, por nuk ka patur llogari rrjedhëse, depozita me afat në emër personal dhe nuk ka qenë në marrëdhënie blerje apo shitje Bono Thesari, obligacionesh apo në marrëdhënie huaje/kredie.

22. Unioni Financiar i Tiranës, me shkresën nr. ** prot., datë 09.05.2023, konfirmon se Sotir Joco ka kryer transaksion në hyrje, në shumën 10.000 lekë, periudha 26.04.2018 - 07.03.2023. Eni Joco, ka kryer transaksion në hyrje në shumën 200 euro, periudha 26.04.2018 - 07.03.2023.

23. Subjekti ka sqaruar se djali Sotir Joco dhe vajza Eni Joco kanë tërhequr shumat 10.000 lekë dhe 200 euro në Unionin Financiar të Tiranës, të dërguara nga miq të tyre me qëllim blerje on-line për këta shtetas. Këto blerje janë kryer nga llogaritë e fëmijëve.

✓ **Subjekti ka sqaruar qëllimin e transfertave nga Unioni Financiar i Tiranës.**

24. AK Invest, me shkresë me nr. ** prot., datë 08.05.2023, konfirmon se shtetasi Sotir Joco, i datëlindjes 06.09.1994, ka kryer 1 transaksion monetar si përfitues, si vijon: shteti dërgues SHBA; shuma: 875 usd; data e transaksionit 02.03.2021; emri i dërguesit Gj. Joco. Shtetasit: Arben Joco, Marika Joco, Eni Joco, nuk kanë llogari, nuk janë klient kredimarrës dhe nuk kanë kryer transaksione nëpërmjet rrjetit AK-Invest Sh.a.

25. Subjekti ka sqaruar se në datë 02.03.2021, shtetasi Gj. Joco (djali i vëllait të subjektit) me banim në SHBA, i ka dërguar djalit të subjektit Sotir Joco, shumën 875 usd me qëllim prenotimin e lokalit, për dasmën e vëllait të tij R. Joco.

✓ **Subjekti sqaroi qëllimin e transfertës nga AK Invest.**

26. QKB, me shkresën nr. ** prot, datë 08.05.2023, konfirmon se shtetasit Arben Joco, Sotir Joco dhe Eni Joco, nuk figurojnë të jenë pajisur me NUIS (NIPT), si persona fizik apo të zotërojnë kuota/aksione në shoqëri tregtare të regjistruara pranë regjistrimit tregtar.

27. DPT, me shkresën nr. ** prot., datë 11.05.2023, konfirmon se shtetasit Arben Joco, Sotir Joco dhe Eni Joco, nuk figurojnë të regjistruar në organet tatimore për ushtrim të ndonjë aktiviteti privat.

28. Drejtoria e Përgjithshme Detare, me shkresën nr. ** prot., datë 10.05.2023, nuk konfirmon mjete lundruese në pronësi të Arben Joco dhe familjarëve të tij.

Përveç sa sipër:

29. Nga Regjistri Noterial ka rezultuar se sipas prokurës së posaçme të mbajtur në datë 28.02.2022, para noterit Luan N. Mucaj, djali i subjektit, Sotir Joco, autorizon shtetasin E. N. të përdorë automjetin me targa AA xxx JK brenda dhe jashtë vendit.

30. Subjektit i është kërkuar të japi shpjegime mbi qëllimin e kësaj prokure të posaçme pa afat dhe lidhjen e djalit të tij me shtetasin E. N.

31. Subjekti në kthim përgjigjet e tij sqaroi se: “Shtetasi E. N. është lidhje miqësore e djalit, aktualisht ka rreth 4 vjet që jeton në SHBA, Texas dhe automjetin e ka përdorur gjatë periudhës së pushimeve të tij në Shqipëri apo jashtë saj. Kjo prokurë është bërë për arsyen e vetme që çdo situatë në lidhje apo gjatë përdorimit të mjetit të ishte e qartë ligjërisht se përdorej nga ky shtetas si brenda apo jashtë vendit.”

Tabela nr.1

Analiza Financiare e subjektit Arben Gjegi Joco dhe personave të tij të lidhur

Burimi/Viti	1994-2004	2005-shtator 2006	tetor 2006-2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	TOTALI
Të ardhura neto nga paga apo shpërthime	4.119,181	1.738.542	1.302.571	551.820	216.086	168.327	603.828	820.474	762.783	940.069	912.964	912.954	1.216.085	1.014.140	968.868	1.198.350	1.333.531	1.334.003	343.305	20.477.833
Të ardhura neto nga akcivitet privat	2.520.000	1.692.238	1.017.000	1.017.000	1.017.000	911.572	714.857	694.374	338.756	392.500	908.855	564.935	1.255.459	392.811	113.356	207.067	215.250	354.105		14.925.365
Të ardhura nga paga M.Joco																				
Të ardhura neto nga interesat bankare		15.629	27.468	25.493	73.080	136.540	140.354	76.152		24.240		24.100	71.259		68.302		341.865			1.024.392
Të ardhura nga paga S.Joco													400.648	466.761			74.828	233.293	130.870	13.86.400
Të ardhura nga paga E.Joco																		353.737	138.994	492.671
Të ardhura të krijuara nga shitja e pasurive																100.000				100.000
Të ardhura të krijuara nga investimi në treg																			845.867	845.867
Të hyra nga detyrimet																2.107.660				2.107.660
Totali i të Ardhurave dhe të Hyrat	6.639.181	3.466.459	2.347.039	1.594.313	1.306.126	1.216.439	1.459.039	1.791.162	1.308.435	1.370.093	2.067.867	2.059.935	3.284.411	2.142.128	1.441.310	3.703.861	2.288.946	2.634.890	1.522.353	43.854.056
Detyrime: Të hyra nga huatë kredit																991.340				991.340
Shpenzime jetike sipas INSTAT	3.108.114	914.304	914.304	546.480	853.003	853.008	853.008	558.192	558.192	944.568	953.484	982.740	970.500	1.028.868	1.107.192	1.118.700	1.138.608	1.188.144	22.786	18.614.200
Shpenzime për Qera									122.222	122.222	122.222	122.222	122.222	122.222	122.222	122.222	122.222	122.222		1.099.998
Shpenzime për Mjekim																3.514.833				3.514.833
Shpenzime për Arsimim							73.333	73.333	73.333	60.000	60.000	60.000	60.000	60.000	145.000	145.000	70.000			879.999
Shpenzime Udhëtim jashtë vendit							7.022	19.968	7.026						31.410	18.645	123.980	89.470	94.193	389.712
Shpenzime Kredit Bankare, Hira, Leasing																		847.860	123.980	991.340
Shpenzime dhe të dala të tjera																				-
Totali i shpenzimeve dhe të dalave	3.108.114	914.304	914.304	546.480	853.003	853.008	893.363	645.493	760.773	1.126.790	1.135.706	1.164.942	1.151.722	1.242.500	1.393.059	5.024.735	2.292.160	1.406.317	22.786	25.490.382
Investime pasuri-shitepi banimi	1.017.392																			1.017.392
Investime pasuri-outveture A.Joco-S.Joco			250.000							61.261						250.000		351.810		964.471
Lik. ALL A.Joco-RFZ Bank (ndryshim)		321.152	183.704	35.461	18.580	121.470	11.497	16.999	375			750	1.800	1.420						
Lik. ALL A.Joco-ISP Bank-Depozite								527.000	440.900	524.391	374.050		141.272		68.302		44.023	0		2.120.038
Lik. ALL A.Joco-Tirana Bank-llug-paga							141.946	19.853	155.616	174.703	7.310	38.046	192.733	157.124	-116.122	320.175	296.422	51.194	41.830	182.644
Lik. ALL M.Joco-RFZ Bank-Depozite	992.964	311.794	655.669	343.473	148.240	148.700	340.558	313.250	1.254.448	73.800	5.288	3.534	179	177	177	177	179	177	177	2.083.865
Lik. ALL M.Joco-BKT Bank-Depozite		302.287	197.713	162.468													297.742	-660.210		300.000
Lik. ALL S.Joco-Credits Bank (ndryshim)																	15.743	-15496	37.111	37.158
Lik. ALL E.Joco-Credits Bank (ndryshim)													77	216	414	640	192	-200		59
Lik. EURO S.Joco (ndryshim)													52.767	-48.401						0
Lik. EURO S.Joco (ndryshim)																452	400	85		137
Konta në Raiffeisen Invest M.Joco									1.829.995											845.867
Gjendje Cash (ndryshim): shtrimit (pakesim)																				2.675.862
Totali Pasuri	2.010.356	935.233	919.678	541.402	129.642	27.230	470.827	809.398	1.171.688	1.094.147	386.648	40.830	385.228	-206.562	-47.229	70.164	56.301	-272.840	924.885	93.81.626
Mundesia për Kursime:	1.520.711	3.137.633	3.630.694	4.157.121	4.480.397	4.816.798	4.971.648	5.213.919	4.599.194	3.999.050	4.544.563	3.398.726	7.145.187	8.251.377	8.346.037	7.947.659	7.897.694	9.399.107	9.973.688	

✓ Në konkluzion për vlerësimin e pasurisë, në përputhje me pikën 6 të nenit 34 të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, trupa vlerësuese, arrin në përfundimin se:

- a) deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare dhe se punonjësi nuk gjendet në situatë konflikti interesi;
- b) nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;
- c) nuk është kryer fshehje e pasurisë;
- ç) nuk është kryer deklarim i rremë;
- d) punonjësi nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

B. KONTROLLI I FIGURËS:

1. Objekti i kontrollit të figurës, sipas nenit 35, të Ligjit nr.12/2018, të ndryshuar është verifikimi i deklaramëve të punonjësit dhe i të dhënave të institucioneve, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklaramëve, si dhe identifikimi i atyre që janë të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.
2. Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të figurës, e kryer nga Trupa Vlerësuese është mbështetur në katër elementë:
 - a) të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në deklaratën e kontrollit të figurës, sipas përcaktimeve të nenit 36, pika 1, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar;
 - b) raporti i hollësishëm dhe i arsyetuar i strukturës përgjegjëse pranë AMP-së sipas përcaktimeve të nenit 42, pika 1, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar;
 - c) të dhënat e mbledhura nga Trupa e Vlerësimit, në institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve të nenit 36, pika 3, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar;
 - d) verifikimin e informacioneve të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e punonjësit apo të personave të lidhur, në zbatim të nenit 36, pika 3, germa (ë), e Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
3. Subjekti Arben Joco ka dorëzuar deklaratën për kontrollin e figurës në zbatim të nenit 36, pika 1, e Ligjit nr.12/2018, të ndryshuar.
4. Në Raportin mbi Kontrollin e Figurës për subjektin e vlerësimit nr. ** prot., datë 18.07.2023, përgatitur nga AMP, trupa është informuar se subjekti i vlerësimit Arben Joco është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.
5. Në *Deklaratën për Kontrollin e Figurës¹, Subjekti i vlerësimit, Arben Joco, nuk ka raportuar ndonjë të dhënë për të cilën duhej të fillonte verifikimi i thelluar sipas kriterëve dhe kushteve të Ligjit nr.138/2015 dhe në zbatim të detyrimit të ligjit të posaçëm nr. 12/2018, i ndryshuar.*
6. Subjekti në *Deklaratën për Kontrollin e Figurës* nuk i është përgjigjur pyetjes nr.17 e Pjesës 5 të Deklaratës mbi “Të dhëna për Sigurinë” nëse nëse ka qenë apo jo anëtar, bashkëpunëtor ose

1

- Nuk ka pasur emër apo mbiemër tjetër më parë.
- Nuk është njohur nga të tjerët me ndonjë nofkë, emër apo mbiemër tjetër nga ai që ka të regjistruar në gjendjen civile.
- Nuk ka patur shtetësi tjetër.
- Nuk është dënuar ndonjëherë më vendim gjyqësor të formës të prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj.
- Nuk ka qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet shqiptar ose i huaj, për kryerjen e një veprë penale.
- Nuk është ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese shqiptare apo të huaja, për kryerjen e një veprë penale.
- Nuk është caktuar ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë penale.
- Nuk ka patur urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale.
- Nuk është marrë ndonjëherë masa e dëbimit nga një shtet i huaj.
- Nuk është në dënim të përfshirjes së ndonjë nga anëtarët e familjes në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar.
- Nuk ka patur kontakte të papërshtatshme në formën e takimit, komunikimit elektronik, ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi të qëllimshëm, me një ose shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës.
- Nuk ka patur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar gjatë ushtrimit të detyrës.
- Nuk është në dënim të përfshirjes së ndonjë nga anëtarët e familjes kanë patur kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhuratat ose pasuri me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk është në dënim të ndonjë nga anëtarët e familjes të ketë pranuar/shkëmbyer para, favore, dhuratat ose pasuri me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
- Gjatë 10 viteve të fundit, nuk i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s.
- Nuk ka patur procedime penale dhe administrative, brenda dhe jashtë vendit, sipas neneve të ligjit për garantimin dhe integritetin e personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.
- Nuk ka fshehur apo keqaprezentuar, falsifikuar, një informacion të një rëndësie të madhe, të një natyre sigurie të veçantë apo të ketë gënjyer gjatë plotësimit të formularit të deklaratës së kontrollit të figurës.
- Nuk ka kryer shkelje sigurie, apo të ketë nëpërkëmbur në mënyrë të përsëritur rregullat e sigurisë së informacionit të klasifikuar, apo të ketë tentuar të kryejë aktivitet të pa autorizuar në sistemet e komunikimit të informacionit të klasifikuar.
- Nuk ka kërkuar ndonjëherë azil politik.
- Nuk është përdorues i lëndëve narkotike.
- Nuk ka varësi nga alkoli dhe lojërat e fatit.
- Nuk ka vuajtur nga çrregullime mendore kronike.
- Nuk ka plotësuar rubrikën e pyetjes nëse ka qenë apo jo anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit para vitit 1991 sipas ligjit “Mbi të drejtën e informimit me dokumentet e ish-shërbimit të sigurimit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit para vitit 1991 sipas ligjit “Mbi të drejtën e informimit me dokumentet e ish-shërbimit të Sigurimit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

7. Në lidhje me këtë fakt i është kërkuar sqarim subjektit i cili është shprehur: *“Lidhur me sa kërkon ju bëj me dije se nuk kam qenë person në ndjekje për spiunazh, anëtar apo bashkëpunëtor i ish-Sigurimit të Shtetit. Kjo vërtetohet me Vendimin nr.192, datë 30.03.2020 të Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, dërguar Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit me shkresën nr.1626/1 prot. datë 31.03.2020.”*
8. Bashkëlidhur subjekti ka vendosur në dispozicion të trupës, kopje të noterizuar të Vendimit nr.192, datë 30.03.2020.
9. Për të kontrolluar figurën dhe saktësinë e deklaramentit për subjektin e vlerësimit, janë kryer veprimet në disa institucione duke kërkuar të dhëna me anë të korrespondencës pranë këtyre institucioneve:
 - ✚ **AKSIK**
 - ✚ **SHISH**
 - ✚ **AMP**
 - ✚ **Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve**
 - ✚ **Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria Gjyqësore**
 - ✚ **Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile**
 - ✚ **Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit**
 - ✚ **Avokati i Popullit**
 - ✚ **AISM**
 - ✚ **Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK)**
 - ✚ **Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit**
 - ✚ **DPPPP**
10. Procedura për kontrollin e figurës është kryer sipas përcaktimeve të nenit 36 -37, të Ligjit nr.12/2018 *“Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”*, të ndryshuar, bazuar në kontrollin e deklaramenteve dhe marrjes së informacionit apo materialeve të tjera nga institucionet publike dhe ato ligjzbatuese, duke i vlerësuar ato bazuar në dispozitat e neneve 38 – 41, të Ligjit nr.12/2018 *të ndryshuar*.
11. Në bazë të informacionit të dërguar nga institucionet përgjegjëse, ka rezultuar se:
 - ✓ Subjekti i vlerësimit është i pajisur me Certifikatë Sigurie Personeli (CSP), nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret”, me Nr.CSP xxxxxx, me datë lëshimi 04.09.2018, të vlefshme deri në datë 03.09.2023.

Nga AKSIK nuk është marrë vendim për refuzim, heqje apo pezullim të përkohshëm CSP. AKSIK nuk disponon rekorde për shkelje sigurie në lidhje me informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror”, të NATO, BE, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

Me shkresën nr. ** prot., datë 03.11.2023 drejtuar Drejtorisë së Analizës dhe Sigurisë së Personelit pranë AMP-së, për shkak të mbarimit të vlefshmërisë së afatit të CSP-së, i është kërkuar informacion nëse është depozituar formulari nga ana e subjektit për rinovimin e saj, në çfarë date, si dhe në cilën fazë të procedurës për tu pajisur me CSP të vlefshme është subjekti.

Sipas shkresës nr. ** prot. kthim përgjigje, Trupës Vlerësuese i është bërë me dije se subjekti i vlerësimit, Arben Joco ka aplikuar për tu pajisur me CSP në datë 06.11.2023 dhe aktualisht është në proces për verifikimin e sigurisë. Me shkresën nr. ** prot., datë 12.12.2023 kthim përgjigje, Drejtoria e Analizës dhe Sigurisë së Personelit pranë AMP, na informon se ka përfunduar procedurat e verifikimit të sigurisë për aplikantin Arben Gjergji Joco dhe në përfundim ka konkluduar se për të, nuk ekziston rreziku i papranueshëm i sigurisë për tu njohur me informacionin e klasifikuar, pasi asnjë agjenci ligjzbatuese nuk administron të dhëna që mund ta implikojnë këtë punonjës policie në veprimtari të kundërligjshme.

- ✓ Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën e saj bën me dije se për subjektin e vlerësimit Arben Gjergji Joco nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile. Në aktin e martesës të mbajtur më datë 21.09.1992, rezulton të jetë pasqyruar rubrika e mbiemrit “Jaco”
- ✓ Nuk ka patur ankesa të trajtuara apo hetime administrative të nisura kryesisht nga Avokati i Popullit, konfirmuar me shkresë.
- ✓ Nuk ka denoncime nga publiku në faqen zyrtare të AMP dhe nuk disponohen ankesa për subjektin e vlerësimit.
- ✓ Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, me shkresë konfirmon se shtetasi Arben Gjergji Joco nuk rezulton i dënuar.
- ✓ Institucioni Ligjzbatues dërgon informacion se subjekti i vlerësimit nuk është i përfshirë në veprimtari që cenojnë sigurinë kombëtare, apo aktivitete të kundërligjshme.
- ✓ Institucioni Ligjzbatues dërgon informacion se për subjektin e vlerësimit nuk administrohen informacione ose materiale mbi përfshirjen e saj në aktivitete të kundërligjshme.
- ✓ Institucioni Ligjzbatues dërgon informacion se për subjektin e vlerësimit nuk figuron i regjistruar për veprimtari kriminale.
- ✓ Prokuroria e Përgjithshme informon se për subjektin e vlerësimit nuk ka nxjerrë urdhër ndalimi, nuk ka kërkuar masa të sigurimit personal (masa shtrënguese/ masa ndaluese, sipas përcaktimeve të nenit 227 të Kodit të Procedurës Penale) dhe vlerësimi i tyre nga Gjykata, nuk është marrë në cilësinë e të pandehurit apo person nën hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 të Kodit të Procedurës Penale, nuk ka pasur regjistrim të njoftimit të veprave penale sipas përcaktimit të nenit 278 të Kodit të Procedurës Penale dhe nuk ka pasur raste të urdhrave ndërkombëtarë të ndalimit.
- ✓ Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), bën me dije se për subjektin e vlerësimit nuk rezulton të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.
- ✓ AMP-ja për subjektin e vlerësimit informon se nuk ka të dhëna për përfshirje në aktivitete të kundërligjshëm, nuk ka procedime penale të referuara dhe nuk administrohen të dhëna ose informacione.

- ✓ AIDSSH-ja për subjektin e vlerësimit bën me dije se nuk ka qenë në ndjekje për spiunazh, terrorizëm si dhe anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit deri në 2 korrik 1991.

Subjekti i vlerësimit Arben Gjergji Joco ka përfunduar Shkollën e Lartë të Ministrisë së Punëve të Brendshme në vitet 1981-1984, profili Sigurim.

Nga verifikimi i Dosjes Personale të Kuadrit për subjektin e vlerësimit, na rezultojnë se gjatë periudhës 01.07.1984 - 01.04.1989 ka punuar si punonjës operativ M.E.S. pranë Degës së Punëve të Brendshme Shkodër dhe për periudhën 01.04.1989 - 15.03.1991 ka punuar me detyrë Shef Seksioni M.E.S. pranë Degës së Punëve të Brendshme Shkodër.

Nisur nga ky fakt, me shkresën nr. ** prot., i është kërkuar AIDSSH-së të na informojë nëse subjekti i vlerësimit Arben Gjergji Joco është “anëtar i ish-Sigurimit të Shtetit”, sipas përcaktimit të parashikuar në nenin 3, pika 4/1 të Ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit me dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar.

AIDSSH-ja me shkresën nr. ** prot., datë 26.10.2023 na ka bërë me dije se: “Nga analiza e dokumenteve në dispozicion rezultojnë se nga verifikimet e deritanishme nuk ka të dhëna që ta lidhin punën e Punonjës Operativ Arben Joco me veprimtarinë e strukturave të ish-Sigurimit, kjo për faktin se ka qenë Punonjës Operativ i seksionit “Policia MES-i”. Ky Vendim i Autoritetit është ende në fuqi.”

12. Testimi për përdorim lëndësh narkotike

12.1 Në zbatim të nenit 38, pika 2, të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, me qëllim vlerësimin e besueshmërisë së punonjësit dhe deklarimeve personale, subjekti i vlerësimit ka kryer testin për përdorim lëndësh narkotike.

12.2 Në përfundim të testit, sipas ekzaminimit toksikologjiko-ligjor nr. xxxx, të ardhur nga Instituti i Mjekësisë Ligjore, me shkresë nr. ** prot., datë 05.12.2023, kemi bërë me dije se:

“Në mostrën e marrë subjektit nuk u zbulua prania e produkteve të lëndëve narkotike të grupit të MOP (opiate/heroinë), COC (cocaine), MTD (metadon), THC (canabinoide/cannabis sativa), BARB (barbiturate), TCA (triciklike antidepressante), AMP (amphetamine), MDMA (ekstazi), LSD (acid lisergjik), BZO (benzodiazepine).”

- ✓ ***Në konkluzion për vlerësimin e figurës, në përputhje me pikën 3 të nenit 42 të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, trupa vlerësuese, arrin në përfundimin se:***
 - a) punonjësi nuk ka kryer deklarin të rremë;***
 - b) nuk ka informacione, të dhëna të vërtetuara nga agjencitë ligjzbatuese që punonjësi është i përfshirë ose i dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar;***
 - c) nuk ka informacion në deklarinin e tij ose nga institucionet përgjegjëse të përcaktuara në këtë ligj, që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.***

C- VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

1. Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin e subjektit të vlerësimit; respektimi i rregullave të etikës dhe i përmbushjes së detyrave nga subjekti, në zbatim të ligjit të vlerësimit nr.12/2018, i ndryshuar si dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të Policisë së Shtetit, sipas përcaktimit në nenin 43 të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.
2. Analiza ligjore e vlerësimit të aftësive profesionale e kryer nga Trupa Vlerësuese është mbështetur në:
 - a) të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar;
 - b) të dhënat e mbledhura në institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 6, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar;
 - c) raporti i hollësishëm dhe i arsyetuar i strukturës përgjegjëse pranë DPPSH-së sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 2 e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar;
3. Trupa përdor si burime për vlerësimin e aftësive profesionale, elementet vlerësuese të përcaktuara në nenin 45, pika 2 të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.
4. Gjithashtu, Trupa e Vlerësimit mban në konsideratë dhe merr në shqyrtim edhe nëse ka denoncime nga publiku për sjellje jo profesionale të punonjësit, apo informacione të tjera të lidhura me ushtrimin e detyrës së tij në mënyrë joetike.

5. Afati kohor brenda të cilit shtrihet procesi i vlerësimit të aftësive profesionale:

5.1 Subjekti i vlerësimit, ka dorëzuar në njësinë e burimeve njerëzore të institucionit ku punon formularin e vlerësimit të aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.

5.2 Periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij ligji, përfshin periudhën bazuar në përcaktimet e nenit 44, pika 2 dhe 3 e tij ².

5.3 Subjekti i vlerësimit kalimtar në momentin e dorëzimit të dokumentacionit ka ushtruar detyrën e Drejtor i Drejtorisë Vendore të Kufirit Migracionit Tiranë.

5.4 Në Raportin e Vlerësimit të Aftësive Profesionale për subjektin e vlerësimit, përgatitur nga DPPSH, trupa është informuar se subjekti i vlerësimit Arben Joco është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

².Periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij ligji, përfshin periudhën që nga data e emërimit të punonjësit në gradën dhe/ose pozicionin që mban, por jo më shumë se 5 vjet. 3. Në rast se punonjësi, në momentin e plotësimit të formularit të vetëvlerësimit profesional, ka më pak se 5 vjet në gradën dhe/ose pozicionin që mban, periudhë vlerësimi konsiderohet e gjithë koha e ushtrimit të detyrës në institucionin përkatës.

6. Niveli i arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin, të subjektit të vlerësimit:

6.1 Subjekti i vlerësimit sipas të dhënave të administruara ka përfunduar arsimin e lartë dhe është diplomuar:

- **Shkolla e Lartë e MPB, Profili i Sigurimit, Diploma nr. regjistri 894, datë 29.06.1984**

6.2 Në kuptim të legjislacionit për Policinë e Shtetit në vite, Ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe VKM Nr. 750, datë 16.09.2015 “Për miratimin e Rregullores së Policisë së Shtetit”, bazuar dhe në kriteret dhe kërkesat e veçanta të pozicioneve të punës për funksionet përkatëse që ka mbajtur subjekti për periudhën e përcaktuar në pikat 2 e 3 të nenit 44, të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, rezulton se: Subjekti i vlerësimit ka qenë në përmbushje dhe përputhje të kriterit të nivelit arsimor për funksionet që ka ushtruar, si dhe me gradat policore që ka mbajtur si punonjës i Policisë së Shtetit.

7. Të dhënat për punësimin dhe ecuria në karrierë:

7.1 Neni 45, pika 2, shkronja dh, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar përcakton se: në lidhje me objektin e vlerësimit të aftësive profesionale shërbejnë edhe ecuria në karrierë dhe procesi i fitimit të gradës, sipas legjislacionit në fuqi.

7.2 Struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore e Policisë së Shtetit na ka vënë në dispozicion dosjen e personelit të subjektit të vlerësimit në të cilën përfshihen akte të ndryshme që i përkasin arsimimit, punësimit, ngritjes në detyrë, gradimeve, kualifikimeve, vlerësimeve, etj... të cilat janë marrë në analizë për vlerësimin profesional të subjektit.

7.3 Në formularin e aftësive profesionale plotësuar nga subjekti i vlerësimit si dhe nga dosja personale e subjektit rezulton se 5 (pesë) vitet e fundit subjekti i vlerësimit ka punuar në funksionet si më poshtë:

- **Drejtor i Drejtorisë Vendore të Kufirit Migracionit Korçë, për periudhën 28.04.2017 deri në 11.06.2020 - sipas Urdhrit nr. 826, datë 27.04.2017 të Drejtorit të Policisë së Shtetit.**
- **Drejtor i Drejtorisë Vendore të Kufirit Migracionit Gjirokastrë për periudhën 12.06.2020 deri në 18.10.2021 - sipas Urdhrit nr. 840, datë 11.06.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.**
- **Drejtor i Drejtorisë Vendore të Kufirit Migracionit Shkodër për periudhën 19.10.2021 deri në 16.12.2022 - sipas Urdhrit nr. 1554, datë 18.10.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.**

- **Drejtor i Drejtorisë Vendore të Kufirit Migracionit Tiranë për periudhën 17.12.2022 deri në momentin e dorëzimit të Formularit të Vlerësimit të Aftësive Profesionale dhe aktualisht - sipas Urdhrit nr.1244/2, datë 16.12.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.**

7.4 Bazuar në nenin 179, pika 10, e Rregullores së Policisë së Shtetit përcaktohet se *transferimi i punonjësit të Policisë bëhet bazuar në kriteret e përcaktuara, të cilat duhet të jenë në përputhje me gradën, kualifikimet, vlerësimet individuale të punës, kohën e qëndrimit në funksion, si dhe me përshkrimin e pozicionit të punës për atë funksion.*

7.5 Sipas Vendimit nr.892, datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e funksioneve korresponduese dhe kategorizimi për Gradat në Policinë e Shtetit”, sipas Tabelës së Funksioneve Korresponduese dhe Kategorizimit për çdo Gradë”, funksioni Drejtor i Drejtorive Vendore të Policisë Kufitare dhe Migracionit duhet të jetë me gradën “Drejtues”

7.6 Subjekti i vlerësimit Arben Joco, në momentin e emërimit dhe mbajtjes së funksioneve si Drejtor i Drejtorisë Vendore të Kufirit Migracionit Korçë, Gjirokastër dhe Shkodër ka qenë me gradën Kryekomisar.

7.7 Sipas nenit 180, pika 1 e Rregullores së Policisë së Shtetit, *punonjësi i Policisë mund të transferohet dhe të emërohet në detyrë në çdo strukturë të Policisë së Shtetit, në përputhje me gradën që ka.*

7.8 Në rastin e transferimit dhe emërimit në detyrë të subjektit, në funksionet e lartpërmendura nuk është mbajtur parasysh përputhja e funksionit me gradën sipas legjislacionit në fuqi të sipërcituar, pasi subjekti duhet të kishte përfituar dhe të gëzonte gradën “Drejtues”.

7.9 Aktualisht që prej 17.12.2022, subjekti mban detyrën e Drejtorit të Drejtorisë Vendore të Kufirit Migracionit Tiranë, dhe emërimi dhe ushtrimi i këtij funksioni është në përputhje të plotë me Vendimin nr.531, datë 29.07.2022 të Këshillit të Ministrave, “Për Miratimin e Numrit të Përgjithshëm të Personelit të Policisë së Shtetit dhe Përcaktimin e Funksioneve Korresponduese dhe Kategorizimin për Gradat në Policinë e Shtetit”.

7.10 Nga aktet e dosjes së personelit, rezulton se subjekti i vlerësimit deri në momentin e deklarimit (5 vitet e fundit) ka përfituar gradat policore si më poshtë:

- **Drejtues: Urdhër nr.1244, datë 24.05.2022**

7.11 Subjektit me Urdhrin nr.164, datë 01.05.2003, të Ministrit të Rendit Publik, “Për inkuadrim të Gradës Ushtarake në Gradë Policore”, i është dhënë grada “Kryekomisar”.

7.12 Sipas Urdhrit nr.1244, datë 24.05.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Për dhënien e gradës policore një punonjësi policie”, subjekti ka marrë gradën “Drejtues”.

7.13 Trupa Vlerësuese konstatoi se përfitimi i gradës Drejtues është kryer sipas dokumentacionit si më poshtë:

- Urdhrin nr.1026, datë 10.11.2021, “Për hapjen e fazës së aplikimeve për konkurrim për fitimin e gradës “Drejtues i Parë” dhe “Drejtues”.
- Vendimin nr.2814/14 datë 22.04.2022 të Komisionit të Gradimit për vlerësimet e aplikantëve që konkurrojnë për fitimin e gradës “Drejtues”.
- Urdhrin nr.408/1, datë 05.05.2022 të Drejtorit të Policisë së Shtetit “Për miratimin e listës emërore të së drejtës për gradë të aplikantëve fitues”.
- Vendimin nr.1/1, datë 19.05.2022 të Komisionit për vlerësimin e Programeve të shkollimit/trajnimit të aplikantëve për marrjen e gradës “Drejtues” në Akademinë e Sigurisë.
- Urdhrin nr.1244, datë 24.05.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Për dhënien e gradës policore një punonjësi policie”, subjekti ka marrë gradën “Drejtues”.

7.14 Në përfundim të verifikimit, rezulton se grada është përfituar në përputhje dhe në zbatim me legjislacionin rregullator të kohës, ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.

8. Vlerësimet e punës:

8.1 Neni 45, pika 2, shkronja ç, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar përcakton se: në lidhje me objektin e vlerësimit të aftësive profesionale shërbejnë edhe vlerësimet e punës.

8.2 Nga aktet e depozituara pranë Trupës Vlerësuese dhe sipas shkresës kthim përgjigje nr. ** prot., datë 21.07.2023, të DPPSH-së, rezulton se për periudhat 2018, 2019, 2020, 2021 nuk ka vlerësime pune të administruara në dosje për subjektin.

8.3 Për vitin 2022 subjekti është vlerësuar “shumë mirë” (95 pikë në total), duke arritur për komponentin e “realizimit të objektivave të punës” të vlerësohet me 55 pikë nga 60 pikë në total dhe për komponentin e “sjelljes profesionale” është vlerësuar me 40 pikë nga 40 pikë në total.

8.4 Nga ana e Trupës i është kërkuar subjektit nëse disponon vlerësimet e punës të cilat nuk është bërë e mundur t'i siguronte zyrtarisht. Në kthim përgjigjet subjekti ka sqaruar se: *“Lidhur me sa kërkohen vlerësimet e punës për këto vite ju sqaroj se vlerësimet e punës janë bërë dhe firmosur nga ana ime ku kam marrë dijeni për vlerësimin e bërë ndaj meje, pikët të cilat janë deklaruar nga ana ime. Këto vlerësime janë kërkuar nga ana ime në dosjen e Sektorit të Burimeve Njerëzore, por nuk janë të administruara. Sqaroj se vlerësimet e punës në kohën e bërjes së tyre, nuk iu vendosen në dispozicion punonjësve. Njihemi me to duke i nënshkruar por nuk marrim kopje të tyre.”*

8.5 Në Formularin e Vlerësimit të Aftësive Profesionale të dorëzuar, subjekti në rubrikën e vlerësimit është shprehur se: “Për vitin 2022 jam vlerësuar me 95 pikë, ose shumë mirë. Edhe për vitet e tjera me sa kam firmosur vlerësimet e punës janë mbi 95 pikë ose shumë mirë”.

8.6 Gjithashtu nga administrimi i dosjes rezulton se subjekti:

- ❖ Me Urdhër nr.06, datë 12.01.2022 të Ministrit të Brendshëm, është vlerësuar me “*Medalje Nderi*”, “Për merita të veçanta në luftë ndaj krimit, sigurimit të rendit dhe qetësisë, profesionalizmit dhe përkushtimit të treguar, duke rrezikuar edhe jetën në përmbushjen cilësore të detyrës, në shërbim të Policisë së Shtetit”.

- ❖ Me Urdhër nr.97, datë 10.01.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit është vlerësuar me *“Certifikatën për shërbime të dalluara”*, *“Për merita dhe shërbime të dalluara në mënyrë të vazhdueshme, duke shfaqur profesionalizëm dhe rezultate të larta në punë, për sigurimin e rendit e të qetësisë publike, në shërbim të Policisë së Shtetit”*.

8.7 Pavarësisht faktit se trupa nuk ka administruar vlerësimet e punës për katër vitet e sipërcituara në gjykimin dhe analizën e saj, ka mbajtur parasysh dekorimin e subjektit nga Ministri i Brendshëm me *“Medalje Nderi”* (2022) dhe *“Certifikatën për shërbime të dalluara”* nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit (2018), të cilat tregojnë për nivelin e lartë të përmbushjes së detyrave, profesionalizmit dhe rezultateve në punë.

8.8 Institucioni i Avokatit të Popullit, me shkresë ka konfirmuar se nuk ka pasur ankesa të trajtuara apo hetime administrative të nisura kryesisht për subjektin.

8.9 Pranë AMP-së, nuk kanë ardhur denoncime/ankesa nga publiku për subjektin për sjellje joprofesionale dhe joetike, gjatë ushtrimit të detyrës të tij sipas parashikimit ligjor të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.

9. Përmbushja e detyrave të kryera

9.1 Neni 43, i Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, përcakton se objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është dhe përmbushja e detyrave nga punonjësi, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin përkatës që rregullon veprimtarinë e punonjësit.

9.2 Neni 45, pika 1, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar përcakton se: aftësitë profesionale të punonjësit vlerësohen duke u bazuar dhe në përshkrimet e punës për çdo funksion.

9.3 Në pjesën 3, pika 1 e formularit të aftësive profesionale të dorëzuar nga subjekti nuk janë përcaktuar detyrat e kryera për çdo funksion, për këtë ju kërkua subjektit nga ana e trupës të rendiste detyrat e kryera prej tij për periudhën e vlerësimit.

Subjekti në përgjigjen e tij sqaroi:

“Drejtor i Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin, ndjek disa nga këto detyra kryesore:

- a) Menaxhon dhe drejton të gjitha çështjet administrative dhe operacionale të Policisë Kufitare dhe Migracionit në territorin që mbulon Drejtoria Vendore e Policisë Kufitare dhe Migracionit.*
- b) Kryen detyra administrative dhe teknike, përfshirë planifikimin, organizimin, mbikëqyrjen, dhe menaxhimin e të gjitha aspekteve të punës në Drejtorinë Vendore të Policisë Kufitare dhe Migracionit, Sektorët, Komisariatet dhe Stacionet vartëse të Policisë Kufitare. Drejtori Vendor për Kufirin dhe Migracionin mund të caktojë detyra jashtë kompetencave të sektorëve të veçantë.*
- c) Zhvillon, koordinon dhe kontrollon zbatimin e akteve ligjore e nënligjore si dhe të detyrave të dhëna sektorëve, Komisariateve dhe Stacioneve në varësi të Policisë Kufitare, për*

kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit, parandalimin e trafiqeve të paligjshme nëpërmjet kufirit, lehtësimin e lëvizjeve ndërkufitare të ligjshme, për qëndrimin, kontrollin, trajtimin e të huajve dhe çështjet e migracionit në territor.

- d) Ndjek zbatimin e programit për zhvillimin e performancës së personelit të Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin dhe identifikon nevojat për trajnim.*
- e) Bashkëpunon dhe koordinon veprimtarinë me strukturat e tjera të Drejtorive Vendore të Policisë, Komisarariatet Vendore të Policisë dhe institucionet shtetërore që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin, shërbimet kufitare homologe, me organizata ndërkombëtare e joqeveritare, si dhe me grupe të komunitetit për të përmbushur përgjegjësitë e drejtorisë.*
- f) Kryen çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga akte ligjore, rregullore dhe dokumente të tjera.*

Të gjitha detyrat e kryera nga ana ime janë bazuar urdhrave të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për emërimin tim në secilën detyrë.”

9.4 Nga verifikimi rezulton se subjekti ka kryer dhe ka përmbushur detyrat në përputhje me përshkrimet e punës për çdo funksion.

10. Respektimi i rregullave të etikës/masat disiplinore:

10.1 Neni 43, i Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar përcakton se objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është dhe respektimi i rregullave të etikës.

10.2 Nga verifikimi dosjes së personelit dhe sistemit RMIS, rezultoi se ndaj subjektit të vlerësimit nuk ka masa disiplinore në fuqi apo të parashkruara për shkelje të rregullave të etikës, sipas përcaktimeve të nenit 43 të ligjit 12/2018, i ndryshuar.

11. Kualifikimet dhe trajnimet:

11.1 Nga verifikimi dosjes së personelit të subjektit si dhe verifikimit të pikës 3, të pjesës 3 të formularit të aftësive profesionale të dorëzuar nga subjekti, rezulton se është pajisur me certifikata për kryerje kursesh, shkollime dhe trajnime brenda dhe jashtë vendit të listuar më poshtë:

- "Zhvillimi i Menaxhimit dhe Udhëheqjes, për Drejtuesit e Lartë të Policisë” MAPE, 23.10.2000 - 03.11.2000.
- “Zbatimi i Ligjit Ndërkombëtar ILEA” viti 2000.
- Kurs trajnimi për "Hetimin e Krimeve në Fushën e Drogave" Tiranë - Nëntor 2002.
- Kurs trajnimi, për Investigimin e Krimit Ndërkombëtar, Korrik 2003 ICITAP.
- Trajnim "Për terrorizmin dhe financimin e tij”. Qershor 2003 Budapest.
- Trajnim " Për Hetimin e Krimit Ndërkombëtar " Qershor 2003 Zagreb - Kroaci.
- Trajnim "Për mbrojtjen e të dhënave, analiza kriminale, operative dhe strategjike" Dhjetor 2006, Tiranë.

- Trajnim "Për menaxhimin, analiza kriminale operative dhe strategjike për menaxheret e nivelit të lartë të Policisë së shtetit shqiptar". Janar 2007. Nga Policia Austriake.
- Trajnim "Për menaxhimin, analiza kriminale operative dhe strategjike për menaxheret e nivelit të lartë të Policisë së shtetit shqiptar". Prill 2007. Vjenë Austri.
- Trajnim " Njohuri mbi sistemin "Patriarch MEMEX " 2011.
- Trajnim " Trafikimi i armëve të zjarrit " Dhjetor 2013 TAJEX Vjenë - Austri.
- Trajnim " Trafikimi i lëndëve radioaktive " 2014 ICITAP - ILEA /Budapest.
- Trajnim " Hetimi i Krimeve të Lehta" Akademia e Sigurisë. 09-20.01.2017.
- Trajnim për "Punën me informacionin e klasifikuar "Sekret Shtetëror" Nëntor 2017.
- Trajnim për "Trafikimin e Veprave të Artit " INTERPOL - Tiranë -2017.

11.2 Megjithëse trajnimet e kryera nga subjekti nuk janë në periudhën sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 2 dhe 3, të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, ato gjithsesi janë të lidhura me thellimin e njohurive, shtimin e vlerave dhe rritjen e performancës në ushtrimin e profesionit të profilit të tij.

11.3 Gjithashtu konstatohet se: Trajnimet dhe pajisja me certifikata trajnimi janë të lidhura dhe në përputhje me objektin e ushtrimit të funksioneve të tij në detyra të ndryshme ku ka punuar.

12. Pjesëmarrja në konferenca shkencore, workshop-e, botime brenda ose jashtë vendit.

Duke ju referuar pikës 5 të pjesës 3 të formularit të aftësive profesionale të dorëzuar nga subjekti, ai ka deklaruar se është angazhuar si vijon:

- Konferenca e dytë ndërkombëtare “Shkencat ligjore dhe sfidat bashkëkohore të sigurisë” – Qendra Kërkimore Shkencore në Akademinë e Sigurisë- Nëntor 2017.

(Pjesëmarrjet në konferenca shkencore, nuk administrohen në dosjen e personelit pasi nuk janë pjesë e saj)

- ✓ *Në konkluzion për vlerësimin e aftësive profesionale, në përputhje me pikën 1 të nenit 47 të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, trupa vlerësuese, arrin në përfundimin se:*
 - a) *është i përshtatshëm duke patur arsimin/trajnimin përkatës për funksionin;*
 - b) *ka vlerësime pozitive pune;*
 - c) *ka rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar atë funksion që mban.*

V. KONKLZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupa e Vlerësimit e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e vlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet nga subjekti i vlerësimit, arrin në përfundimin se subjekti i vlerësimit z. **Arben Joco**, në përputhje me nenin 60, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë,
- Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e kontrollit të figurës,
- Konstatohet nivel i mjaftueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE:

Trupa e Vlerësimit, bazuar në pikën 7, të nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në bazë të germës “a”, të nenit 59, si dhe të pikës 1 dhe 2 të nenit 60, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të vlerësimit, z. Arben Gjergj Joco, me funksion aktual Asistent, në Departamentin e Policisë Kriminale, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet subjektit të vlerësimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit brenda 15 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 45 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim u shpall në Tiranë, sot datë **14.02.2024**.

TRUPA E VLERËSIMIT

Henri Naqellari
Kryesues

Loreta Hanxhari
Relatore

Bora Vrenjo
Anëtare